



EMERGJENCA



Nisma vazhdon: 1000 forca të FA dhe 80 mjete pastrojnë mjedisin

Ministrja Kodheli inspekton aksionin e FA për pastrimin e territorit nga mbetjet

faqe 2

PROJEKTET/ ITALIANËT

Gjeneralmajor Jeronim Bazo takon përfaqësuesit e kompanisë "Selex"

faqe 3

SIMULIMI

QS dhe QNOD zhvillojnë stërvitjen ndërinstucionale "Pulëbardha 14"

Zhvillimi i këtyre lloj stërvitjeve përbën risi për ne dhe ecuria e deritanishme është pozitive

faqe 5

FORCË TOKËSORE



Ndërveprimi me britanikët, progres edhe në të ardhmen

Gjeneralmajori britanik Ed Davis, zhvilloi një vizitë në Komandën e FT

faqe 3

BASHKËPUNIMI

Ministrja Kodheli priti komandantin e Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajorin Ed Davis

Gjatë takimit u shpreh bindja se bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes do të forcohet më shumë



faqen 2

Realizimi në kohë rekord dhe me fonde minimale

Vihet plotësisht në funksionim sistemi i radarëve në QNOD

Drejtuesit dhe specialistët e këtij institucioni, i konfirmuan ministres së Mbrojtjes se sistemi i radarëve, i cili ishte jo funksional prej mëse tri vitesh, tashmë është vënë plotësisht në gjendje pune



faqen 3

MINISTRJA KODHELI: KAPITEN FETIU LA PAS VEPRËN E TIJ QË VËSHITËRË SE DO TË MUND TË HARROHET

Përkujtohet 2-vjetori i rënies së Dëshmorit të Atdheut, kapiten Vogli



Kapiten Feti Vogli shkëlqeu në pasionin e tij për punën dhe për këtë gëzoi respekt dhe besim nga të gjithë kolegët dhe bashkëluftëtarët e tij. Gjatë gjithë kohës së shërbimit të tij, atë e karakterizonte përkushtimi i lartë ndaj detyrës.

faqe 8-9

KDS/ BASHKËPUNIMI

Konsolidohen programet me Gardën e New Jersey-it

faqe 5

FORCË DETARE

Anije të SNMCMG2 vizitojnë portin e Vlorës

faqe 10

AMANETI PËR FETI VOGLIN

In memoriam - Për kë mund të shkruaje tani, o Gjokë?

faqe 15

DOKTRINA



Promovimi i botimeve doktrinare dhe sfidat për të ardhmen

Diskutohet mbi rëndësinë e koncepteve doktrinare dhe domosdoshmërinë e publikimit të tyre

faqe 6-7

Vihet plotësisht në funksionim sistemi i radarëve në QNOD

Drejtuesit dhe specialistët e këtij institucioni, i konfirmuan ministres së Mbrojtjes se sistemi i radarëve, i cili ishte jo funksional prej mëse 3 vjetësh, tashmë është vënë plotësisht në gjendje pune

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 19 shkurt 2014, zhvilloi një vizitë në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) në Plepa, Durrës, me rastin e ngritjes së kapaciteteve të vëzhgimit të hapësirës detare. Ajo u prit nga drejtori i kësaj qendre gjeneralmajor në rezervë Maksim Malaj. Ministrja Kodheli u njoh nga afër me punën që bëhet për vëzhgimin dhe kontrollin që i bëhet hapësirave detare nga personeli i kësaj qendre. Gjatë takimit dhe bisedave që zhvilloi me drejtuesit dhe specialistët e këtij institucioni, ministres së Mbrojtjes iu konfirmua se sistemi i radarëve, i cili ishte jo funksional prej mëse 3 vjetësh, tashmë është vënë plotësisht në gjendje pune. Vetëm një ditë më parë funksionimi i këtij sistemi ka dhënë rezultatin e tij, duke bërë të mundur zbulimin dhe ndalimin e një anije në ujërat e Ksamilit, e cila u detyrua të hedhe në det një sasi prej 50 kg marijuanë. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, duke u ndalur tek rëndësia e këtij sistemi jo vetëm për ecurinë e punës të Ministrisë së Mbrojtjes apo Ministrisë së Brendshme, por edhe për informacionet që duhet të shkëmbejmë me partnerët tanë ndërkombëtarë, theksoi se tashmë ne nuk jemi më pa sy. Znj. Kodheli tha në fjalën e saj se:

“Sot është vërtet një ditë e veçantë, për një aktivitet, për të cilin MM është përgjegjëse, por përgjegjëse janë edhe të gjitha institucionet që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me QNOD. Më duhet vetëm t’ju informoj se për fat të keq Shqipëria ishte komplet “e qorrur” për sa i përket në raport me detin; thënë më thjeshtë radarët nuk punonin. Shqipëria me të gjitha strukturat e saj qeverisëse, mbështetëse, kushtetuese, nuk mund të shikonte se kush ishte në detin shqiptar, nuk mund të verifikonte se 500 anijet e peshkimit - që kanë licencë për të zhvilluar këtë aktivitet, ku ndodheshin, - a ishin në vëzhgimin, a kishin dalë në det, a ishin për të peshkuar, apo anije të tjera ishin futur në ujërat territoriale të Shqipërisë. Shqipëria nuk siguronte dot ruajtjen e bregdetit të saj prej tre vitesh dhe shumë më shumë se kaq. Sot është bërë e mundur vendosja në punë e radarëve të cilët “i kanë hapur sytë” Shqipërisë, kanë rritur sigurinë e Shqipërisë, e kufirit të saj detar, kanë rritur sigurinë e qytetarëve të saj, kanë rritur sigurinë e, - sidomos atyre që me detin e kanë të lidhur jetën dhe veprimtarinë - siç janë peshkatarët. Por njëkohësisht ka rritur sigurinë edhe në raport me fqinjët, ka rritur sigurinë në raport me trafiket, qofshin këto humane apo të natyrave të tjera dhe kjo është një përgjigje që ne i japim sot problematikës së jashtëzakonshme të trafikëve të së gjitha llojeve, që për fat të keq bëhen shpesh objekt i diskutimit jo



vetëm brendapërbrenda vendit por edhe jashtë kufijve të vendit. Kjo gjë është realizuar në një kohë rekord. I falënderoj të gjithë ata që kanë punuar me përkushtim për këtë gjë. Është realizuar brenda një shume e cila ishte e paimagjinueshme me qeverisjen e djeshme se do të mund të realizohej - me gjysmën e asaj shume të caktuar për t’i rregulluar këto radarë të cilët prej tre vjetësh nuk funksiononin dhe nuk u rregulluan kurrë, për arsye që qeveria e djeshme e di. Ajo ç’ka është më e rëndësishme sot është se Shqipëria është një vend më i sigurt, qytetarët e saj janë

më të sigurt, bizneset që lidhen me detin janë më të sigurt dhe e gjitha kjo është falë punës, devotshmërisë, dedikimit të MM dhe të së gjithë institucioneve siç janë Ministria e Brendshme, Doganat, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen me këtë qendër. E fundit gjë që dua t’ju them, miqësisht, është se Ministria e Mbrojtjes dhe FA do të jenë gjithmonë prezent atje ku do të ketë problematika të mëdha, do të ketë emergjenca, pavarësisht nëse këto emergjenca quhen ruajtje në det, pavarësisht nëse këto emergjenca quhen

pastrimi i territorit, pavarësisht nëse këto emergjenca kanë një natyrë tjetër - ne do të jemi këtu për t’iu përgjigjur nevojave të qytetarëve tanë, të sovranitetit të vendit tonë dhe padyshim nevojave që sot Shqipëria ka në raport me vendet e tjera fqinjë në rrugën drejtë dhe të vetme të integritimit evropian.”

Vendosja në funksion të plotë e këtij sistemi, është realizuar me fonde më pak Ky sistem garanton se Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura do të jenë kudo ku qytetarët shqiptarë kanë nevojë për ta, në çdo lloj emergjence.

Ministrja Kodheli priti komandantin e Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajorin Ed Davis

Gjatë takimit u shpreh bindja se bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes do të forcohet më shumë

Ministra e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli priti në datë 17 shkurt 2014, në një takim të veçantë komandantin e Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajor Ed Davis, i cili ndodhet në vendin tonë për një vizitë zyrtare në kuadër të marrëveshjes bilaterale Shqipëri-Britani e Madhe. Në takim ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Tiranë, z. Nikolas Cannon. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, pasi i ka uruar mirëseardhjen në Tiranë gjeneralmajor Davis, ka vlerësuar mbështetjen dhe ndihmën që Britania e Madhe i ka dhënë Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura shqiptare në rrugën e integritimit euroatlantik, duke nënvizuar se edhe kjo vizitë është shprehje e këtij bashkëpunimi në rritje ndërmjet dy forcave të tona të armatosura. Nga ana e tij, gjeneralmajor Ed Davis falënderoi ministren Kodheli për pritjen e ngrohtë që i rezervoi,



si dhe vlerësoi arritjet e deritanishme të FA shqiptare në procesin e reformimit të tyre dhe të integritimit të plotë në strukturat e NATO. Gjeneral Davis u shpreh se

vizita e tij në vendin tonë, e dyta brenda shumë pak kohësh, është një tregues i qartë i bashkëpunimit shumë të mirë mes këtyre dy vendeve. Duke u ndalur tek

Ministrja Kodheli inspekton aksionin e FA për pastrimin e territorit nga mbetjet

Nisma vazhdon: 1000 forca të FA dhe 80 mjete pastrojnë mjedisin

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ditën e shtunë, në datën 15 shkurt 2014, kanë inspektuar nga afër fazën e dytë të aksionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e territorit. Fillimisht, ata janë ndalur në pikën doganore të Morinës, ku forca të shumta të ushtrisë ishin duke pastruar territorin. Më tej, kanë ndalur përgjatë gjithë akseve rrugore nga Morina deri në Tiranë, ku efektivat e Forcave të Armatosura ishin të angazhuara dhe kanë parë nga afër aksionin e pastrimit të mbetjeve. Në fjalën e saj, ministrja Kodheli u shpreh se duhet ta mbajmë të pastër Shqipërinë dhe gjendjen mjedisore në të gjithë territorin e vendit e ka cilësuar si Emergjencë Mjedisore. Më tej, ministrja Kodheli theksoi se qeveria ka disponibilitetin maksimal për ta mbajtur të pastër mjedisin. Në takimet që zhvilloi me disa prej banorëve të zonave, ministrja Kodheli u ka tërhequr vëmendjen atyre dhe u ka kërkuar që ta mbajnë të pastër ambientin në të cilin jetojnë, si dhe u bëri thirrje të gjithëve që të bëhen pjesë e këtij aksioni. Në këtë aksion janë angazhuar 1000 forca të FA dhe 80 mjete. Akset kryesore në të cilat Forcat e Armatosura kanë ndërhyrë gjatë ditës së sotme janë: Dogana Morinë-Ura e Drinit Kukës, 20 km; Milot-Rubik, 12 km; Milot-Kukës, 32 km; Kamëz-Vorë, 12.5 km dhe Kashar-Aeroporti i Rinasit, 7 km. Në total janë pastruar 83.5 km rrugë kombëtare dhe mbetjet e nxjerra janë transportuar me mjetet e FA për në vendgrumbullimet e tyre.

Ndërveprimi me britanikët, progres edhe në të ardhmen

Gjeneralmajorit Ed Davis iu rezervua një pritje e veçantë nga shefi i SHP, gjeneralmajor Bazo

Komandanti i Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajor Ed Davis zhvilloi një vizitë zyrtare në Forcat e Armatosura të RSH, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes Shqipëri - Britani e Madhe. Gjeneral Davis u prit me truprojë nderi nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Viktor Berdo. Të pranishëm në ceremoni ishin drejtorë drejtorish në MM dhe SHP. Komandantit të Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajor Ed Davis iu rezervua një pritje e veçantë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneral Bazo pasi shprehu kënaqësinë për vizitën dhe e falënderoi për mbështetjen që Britania e Madhe i ka dhënë Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura Shqiptare, nënvizoi se vizita është një shprehje e bashkëpunimit në rritje e sipër ndërmjet dy forcave të armatosura. "Forcat e Armatosura shqiptare janë në një periudhë transformimi dhe në këtë kuadër forcimi i bashkëpunimit me vendet aleate dhe partnere merr një rëndësi të veçantë. Ne jemi duke rishikuar dokumentet strategjike në tërësi, që të mund të gjejmë më mirë reflektim, benefitet dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO. Në këtë kuadër, duke zbatuar reko-

mandimet e dokumentit të RSM, Forcat e Armatosura shqiptare janë duke kryer transformimin e radhës duke implementuar një strukturë të re...", - është shprehur ndër të tjera gjeneral Bazo. Nga ana e tij, gjeneral Davis falënderoi gjeneral Bazon për pritjen e ngrohtë dhe miqësore që iu rezervua, vlerësoi arritjet e deritanishme të FA shqiptare, si dhe shprehu bindjen se bashkëpunimi midis dy forcave të armatosura në fushën e mbrojtjes do të shënojë progres edhe në të ardhmen, dhe kryesisht në trajnimin e nënoficerëve, në trajnimin për zhytësit, trajnimet për bordimet detare, si dhe në ndërveprimin mes Forcave Speciale të FARSH dhe Marinsave Mbretërorë britanikë. Gjeneral Bazo, duke e falënderuar për bashkëpunimin e ofruar, u shpreh se këto fusha janë të një interesi të veçantë për FARSH, pasi një pjesë e tyre janë pjesë edhe e paketës së detyrimeve tona ndaj NATO. "Nëpërmjet këtij bashkëpunimi rritet fuqia ndërvepruese e personelit dhe kapaciteteve tona pjesëmarrëse në trajnim, theksoi gjeneral Bazo në përfundim të takimit. Më herët, komandanti i Marinsave Mbretërorë britanikë, gjeneralmajor Ed Davis, u prit nga Ministrija e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli.



Gjeneralmajori britanik Ed Davis, zhvilloi një vizitë në Komandën e FT

Premtohet për thellim bashkëpunimi britaniko-shqiptar në të ardhmen

Me datë 18 Shkurt 2014, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes Shqipëri - Britani e Madhe, komandanti i Marinsave Mbretërorë britanik, gjeneralmajor Ed Davis, i shoqëruar nga Ambasadori Britanik në vendin tonë, Shkëlqesia e Tij, Nicholas Cannon dhe atasheut ushtarak i akredituar në vendin tonë nënkolonel Richard Parry, zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën e Forcave Tokësore. Delegacioni britanik u prit në një takim të veçantë nga komandanti i Forcave Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku. Gjeneral Dushku, pasi ju uroj mirëseardhjen, shprehu kënaqësinë për vizitën dhe e falënderoi gjeneral Davis dhe ambasadorin Cannon, për mbështetjen që Britania e Madhe po jep për Forcat e Armatosura dhe në veçanti për Forcat Tokësore Shqiptare. Ai i njohu ata, me aktivitetet e përbashkëta, të cilat janë intensifikuar pas anëtarësimit në NATO dhe që po i japin një dimension tjetër Forcave tona të Armatosura në kuadrin e transformimit të vazhdueshëm. "Përvoja e fituar në aktivitetet e përbashkëta, eksperiencia e gjatë në stërvitje brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrja në të njëjtat operacione, si në Irak, Afganistan apo Kosovë, u shpreh gjeneral Dushku, ka qenë një mundësi e mire për efektivat e Forcave Tokësore që të arrijnë nivelin e duhur profesional e ndërveprimin me forcat aleate, përfshi ato të Britanisë së Madhe. Përfitimet dhe detyrimet në kuadër të Aleancës Euro-Atlantike, vijoi ai, krijojnë hapësirat e duhura për angazhime të përbashkëta për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Aktualisht jemi në fazën e implementimit të Dokumentit Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM), ku vendin kryesor e zë implementimi i strukturë së re si dhe ndryshimet në paketën ligjore në përputhje me realitetin e ri, si një vend anëtar i NATO-s. Më tej gjeneral Dushku u shpreh se Grup Batalioni i Motorizuar është synimi ynë afatgjatë dhe është prioritet për Forcat Tokësore. Kjo do të arrihet pasi të zhvillojmë batalionin e këmbësorisë



në planin afatmesëm si njësi bazë e Grup Batalionit. Në planin afatshkurtër mbetet një kompani këmbësorie, e cila synohet të konsolidohet brenda këtij viti me qëllim që në vitin e ardhshëm të kalojë të gjitha fazat e trajnimit, certifikimit dhe vlerësimit për të qenë e gatshme si nënrepart e

Forcave të Reagimit të Shpejtë (NRF) të NATO-s. Organizimi, trajnimi, stërvitja dhe modernizimi i këtyre reparteve dhe nënreparteve mbetet fokusi kryesor për Forcat Tokësore. Mbështetja e Britanisë së Madhe ka qenë mjaft e dobishme, në të gjitha fazat, si para dhe pas anëtarësimit në

Aleancë. Shpreh bindjen se vullneti është i përbashkët për ta intensifikuar më tej këtë bashkëpunim të ndërsjellë...". Gjeneral Davis pasi u njoh me Forcat Tokësore, organizimin dhe funksionimin e tyre, detyrat që po kryen dhe planet për të ardhmen, falënderoi gjeneral Dushkun për pritjen e

ngrohtë dhe miqësore që iu rezervua. Nga ana e tij u vlerësuan arritjet dhe progresi i deritanishëm, duke u ndalur në thellimin e bashkëpunimit për të ardhmen. Më tej ai siguroi se ky bashkëpunim në fushën e mbrojtjes do të shënojë progres dhe do të përfshijë fushat që paraqesin interes për zhvillim të mëtejshëm, si: trajnimi bazë i oficerëve dhe nënoficerëve, trajnimi i zhytësve, trajnimi i bordimit detare, si dhe në ndërveprimin mes Forcave Speciale të FARSH dhe Marinsave Mbretërorë britanike. Një pikë e veçantë bisedimi ishte menaxhimi i personelit dhe siguri i efekshmërisë maksimale në përzgjedhje, trajnim, caktim në detyrë dhe promovim të tyre. Për këtë qëllim kërkohet që të ulemi bashkërisht të vlerësojmë planet dhe përcaktojmë piketat kryesore për ndërveprim. Gjeneral Dushku, duke e falënderuar për mbështetjen ritheksoi se gjithçka do të jetë e sinkronizuar me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA, për të siguruar një bashkëpunim të frytshëm në interes të konsolidimit të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe rritjen e ndërveprimit me Forcat Britanike.



Gjeneralmajor Jeronim Bazo takon përfaqësuesit e kompanisë italiane "Selex"

Axhenda e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka vijuar mesditën e datës 17 shkurt 2014, me një takim të veçantë me delegacionin e inxhinierëve italianë të kompanisë "Selex", i cili po zhvillon një vizitë dy ditore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm. Qëllimi i kësaj vizite është prezantimi i projekteve nga kompania "SELEX" i sistemeve të radarëve për mbrojtjen ajrore, sistemit për kontrollin e brigjeve detare, informatizimin e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për krijimin e një sistemi komunikimi ndërinstitucional të sigurisë "TETRA" ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar projektet e paraqitura nga përfaqësuesit e kompanisë "Selex", si një kompani serioze dhe me standarde konkurruese në tregun evropian dhe më gjerë. Vizita e inxhinierëve të kompanisë "Selex" do të vijojë ditën e nesërme, me takimin në nivel ekspertësh të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, të cilët do të diskutojnë dhe vlerësojnë në mënyrë specifike ofertat e paraqitura nga kompania italiane.

Burimi: mod.gov.al / aaf.mil.al

KDS vijon vazhdën e angazhimit për pastrimin e territorit

Në kuadër të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë pastër" dhe shpalljes së emergjencës civile për gjendjen e mjedisit që nga java e kaluar, ka vijuar përsëri angazhimi i personelit ushtarak të KDS, edhe për ditën e sotme. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, datën 15 shkurt, është angazhuar në aksin rrugor: Krahu i djathtë i autostradës Vorë-Tiranë. City Park- Mbikalimi këmbësor Kashar - Kthesa e Kamzës, duke pastruar të gjithë këtë aks në një shtrirje prej 5 Km. Kjo komandë angazhoi rreth 70 forca dhe 5 mjete, personel i Akademisë së Nënoficerëve dhe Shtabit të KDS, duke bërë të mundur pastrimin dhe transportimin e rreth 6 ton mbetje të integruara urbane drejt landfillit të Sharrës në Tiranë. Aksioni për pastrimin e mbetjeve u drejtua nga shefi i Shtabit i KDS-së kolonel Riza Zaja dhe zv/komandanti i Akademisë së nënoficerëve,

cerëve, n/kol Muhamed Guza. Gjatë aksionit për pastrimin e mbetjeve të integruara urbane, mbërriti për inspektim dhe ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Ministrja Kodheli, pasi falënderoi për angazhimin, përkushtimin si dhe përgjegjshmërinë e treguar të forcave ushtarake në kryerjen e këtij operacioni të bashkëpunimit civilo-ushtarak, ndër të tjerash u shpreh se: "Shqipëria është e jona, jemi ne që duhet ta mbajmë të pastër. Ky mesazh është për të gjithë ne që jetojmë në këtë ambient". Nëpërmjet këtij mesazhi, tregohet edhe njëherë roli pozitiv i forcave ushtarake në kontributin që jep ndaj komunitetit, mbrojtjen mjedisore, si pjesë e këtij komuniteti dhe e shoqërisë civile në tërësi, duke qenë "Qytetarë nën uniformë". **Nënkolonela Alda Sula**



Forcat Tokësore japin kontributin e tyre në përgjigje të emergjencës mjedisore

MAJOR NEXHBEDIN BASHA

Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë pastër", kjo është motoja që po inspirohen Forcat e Armatosura për mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e territorit. Forcat Tokësore, si pjesë kryesore përbërëse e FA-së, më datë 15 Shkurt 2014 u angazhuan me strukturat e saj, batalionin e Parë të Këmbësorisë, Vau Dejës, batalionin e Dytë të Këmbësorisë, Zall Herr, batalionin Komando, batalionin e Forcave Speciale dhe shtabi i FT-së, në pastrimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në një territor të kontaminuar në aksin rrugor Luzë (Fushë Krujë) – fillimi i autostradës (Thuman) dhe rreth rrotullimi i Milotit, përgjatë autostradës Tiranë – Durrës dhe Kthesa e Kamzës – Vorë, Ura e Drinit – Pika kufitare e Morinit dhe Kamëz – Fushë Krujë, Qendër Kamëz – Nikël, në qarqet në qarqet Tiranë, Durrës dhe Kukës. Forcat Tokësore angazhuan rreth 550 trupa dhe 35 mjete. Puna për rehabilitimin e territorit po vazhdon intensivisht, në të cilën janë përfshirë strukturat në të gjitha nivelet e komandim-kontrollit të Forcave të Armatosura dhe e koordinuar me të gjithë strukturat e tjera të Task-Forcës dhe organeve vendore. Forcat Tokësore, vlerësojnë këtë veprimtari si masë sensibilizuese për të gjithë qytetarët,



për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e tij. Trupat e angazhuara në këtë aktivitet u inspektuan nga ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zv.shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Viktor Berdo dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Është për tu përmendur se ky operacion kryhet pas një pune intensive për-

gatitore me të gjithë personelin ushtarak, duke përfshirë masa instruktivo-metodike, tekniko-organizative dhe masa të sigurisë në punë. Një veprimtari e tillë shfaq dukshëm impaktin pozitiv tek qytetari - si detyrim nga secili për një ambient sa më të pastër. Mbi të gjitha vërehet se gjatë gjithë fazave të operacionit ka një bashkëpunim të admirueshëm me organet e pushtetit vendor. Pas ditës së parë të punës, në Shkodër dhe Lezhë, u kryen vlerësimet

dhe analizat e nevojshme duke vënë theksin në ndonjë mangësi të vërejtur dhe trajtuar atë si mësim i nxjerrë dhe reflektim të menjëhershëm për të ardhmen. Impenjimi në aksin rrugor autostrada Tiranë- Durrës, Kamëz-Ura e Milotit, Ura e Drinit – Pika kufitare e Morinës etj, në datën 15 shkurt ishte më i lartë dhe me masa më të plotë nga të gjithë komandantët. Gjeneralmajor Zyber Dushku, në takimet e tij me efektivat ka nënvizuar se është detyrimi ynë

të përcjellim tek qytetari se "Ambienti është i përbashkët dhe ne të gjithë duhet ta mbajmë atë të pastër". Është detyra jonë të prezantohemi në modelin më të mirë, serioz dhe të disiplinuar, të angazhuar maksimalisht, për të siguruar përfundimin me sukses të detyrës, në kohë dhe me cilësinë e duhur. Vlen të përmendim masat koordinuese të marra, si brenda strukturave të FA-së ashtu edhe me strukturat e pushtetit vendor. Procesi ishte aq i mirë-koordinuar, ku nuk mund të dalloje zonat e pastrimit ndërmjet forcave apo reparteve të ndryshme, pasi gjithçka ishte në sinkronë të plotë. Ndihej ishte e dy anshme, pasi forcat tona ushtarake dhe qytetarët njëkohësisht me këto lloje veprimtarish, njohin dhe e prekin së bashku realitetin, si dhe konkretizojnë vënien në shërbim të njëra tjetrës. Kuptohet se, kalimi nga një gjendje e ndotur në një ambient të pastër nuk do të jetë e lehtë, por jo e pamundur. Pas arritjes së këtij objekti, mbetet detyrim mbarë-qytetar për të mbrojtur ambientin dhe mbajtur atë të pastër. Këtu në terren, kupton mjaft mirë se ky proces kërkon bashkëpunim, por mbi të gjitha mirëkuptim mbarë-qytetar. Nëse respektohet kjo iniciativë nga të gjithë shoqëria shqiptare, me të njëjtin nivel siç edhe po veprojnë Forcat e Armatosura, Shqipëria shumë shpejt do të jetë e pastër. Motoja "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër" të kthehet në normë për të gjithë.

I pyetur për gazetën "Ushtria", se cili është opinioni juaj në lidhje me kontributin që po japin FA në pastrimin e territorit të RSH me moton "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë pastër", Zoti Altin Jaku, Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, Lezhë, shprehet: Së pari, vlerësoj maksimalisht angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në përballimin e emergjencës mjedisore, e cila po jep një impakt pozitiv në zgjimin e një ndërgjegjësime mbarë shoqëror. Shembulli që po jep ushtria është modeli më i mirë që ofrohet sot për të siguruar një ambient tërësisht dhe gjithnjë të pastër. Nuk është hera e parë që ushtria me modestinë e saj, tregon modelin më të mirë për të bërë realitet atë që thuhet dhe për më tepër të konkretizojë rezultatet në kohë rekord dhe me cilësinë e duhur. Për më tepër Forcat e Armatosura janë

Flet Altin Jaku, Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, Lezhë "FA po japin një impakt pozitiv mbarëshoqëror"

të parat që po veprojnë në terren në përkrahje të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë pastër".

Ishte fat për ne që në qarkun e Lezhës u angazhuan forcat elitë të ushtrisë, si Forcat Speciale, Forcat Komando, Forcat e Policisë Ushtarake, të ANSI-së, etj. Imazhi që ju dhatë në Lezhë ishte një pikënisje për të ndërgjegjësuar masën e gjerë qytetare në këtë qytet që të kontribuojnë me të njëjtin model. Kush ishte në terren e pa qartë se popullata, veçanërisht në qytet tregoi gatishmërinë për t'iu përgjigjur me të njëjtin monedhë ushtrisë. Duke shprehur mirënjohje për punën dhe ndihmën e dhënë, e shoh me vend se aktivitete të tilla jo vetëm



që ndihmojnë procesin siç është përballimi i emergjencës ambientale, por edhe një mundësi e mirë për integrim të strukturave civile dhe atyre ushtarake për ti shërbyer sa më mirë vendit. Ky aktivitet shërbeu si masë përgatitore për të qenë të gatshëm për përballimin

e situatave të tjera të emergjencave të mundshme që mund të shkaktohen nga natyra apo njeriu. Gjej rastin të përcjell nëpërmjet gazetës ushtria, një falënderim të përzemërt për drejtuesit kryesor të Mbrojtjes, ministren Mimi Kodheli, Shefin e

Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo që janë në krye të kësaj veprimtarie rehabilituese të mjedisit. Në mënyrë të veçantë dua të përgëzojë ata që veprojnë drejtpërdrejt në pastrimin e ambientit, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, me shembullin e të cilëve i ndryshuan faqen aksit Milot - Lezhë. Tani mbas kësaj pune të shkëlqyer tuajën është detyrimi ynë ta mbajmë pastër mjedisin. Kjo mendoj se do të arrihet jo vetëm nëpërmjet masave ndërgjegjësuese, por edhe aplikimin e masave administrative, si për organizmat shtetërorë ashtu dhe ato privat, në mënyrë të veçantë ndaj kompanive të ndryshme, që operojnë në prefekturën tonë. Është detyrimi i çdo qytetari, të mos krijojë ndotje të ambientit, në të kundërt, do ti nënshtrohet sanksioneve me masa dëmshpërbluese.

QS dhe QNOD zhvillojnë stërvitjen ndërinstytucionale “Pulëbardha 14”

Zhvillimi i këtyre lloj stërvitjeve përbën risi për ne dhe ecuria e deritanishme ka treguar se jemi në gjendje të marrim përsipër dhe risi të tilla

Në ambientet e Qendrës së Simulimit (QS), është duke u zhvilluar stërvitja e përbashkët me QNOD, e quajtur “Pulëbardha 14”. Në këtë stërvitje, e një niveli ndërinstytucionale, marrin pjesë përfaqësues nga institucionet e Ministrisë së Mbrojtjes, së Brendshme, e Turizmit, Transportit, Ekonomisë, Infrastruktura, Kulturës e Financës. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e ndërvprueshmërisë së këtyre institucioneve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe operimi sa më i shpejtë që të jetë e mundur kundër problematikave të ndryshme me të cilat përballen në terren këto institucione. Komandanti i QS, kolonel Dritan Demiraj, për këtë stërvitje shprehet se: “QS është motor i stërvitjeve të përbashkëta, si brenda FA por edhe për stërvitje ndërinstytucionale, rasti i së cilës është stërvitja “Pulëbardha 14”, me pjesëmarrje të gjerë institucionale. Zhvillimi i këtyre lloj stërvitjeve përbëjnë risi për ne, dhe ecuria e deritanishme ka treguar se jemi në gjendje të marrim përsipër dhe risi të tilla, ku ndërthuret puna e përbashkët e të gjithë institucioneve shtetërore në zgjidhjen e situatave të ndryshme që kanë të bëjnë me k/terrorizmin, pengmarrjen në det, kontrollin e mjeteve detare, porteve, kërkim-shpëtimin, e deri tek ndotjet mjedisore e balanca ekologjike. Janë të gjithë këto situata, të cilat në këtë stërvitje përbëjnë skenarë të mundshëm, ku të gjithë institucionet nëpërmjet koordinatorëve të tyre, bashkëpunojnë e bashkëprojnë,



duke rritur ndërvprueshmërinë dhe gatishmërinë në funksion të qëllimit që kjo stërvitje ka në vetvete. Shumëllojshmëria e këtyre skenarëve përbën një tjetër risi, me qëllim standardizimin e veprimeve me ato të NATO-s, nëpërmjet krijimit të SOP-ëve të përbashkëta – përfundon kolonel Demiraj”. Stërvitja do të ketë si objektiva; Rritjen e njohurive dhe nivelit të kuptueshmërisë rreth misionit dhe përgjegjësisë të QNOD-së nga ana e ministrive pjesëmarrëse dhe agjencive mbështetëse; vlerësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe

koordinimit midis institucioneve pjesëmarrëse në QNOD në zbatimin e ligjit në det; transferimi i autoritetit komandues në operacion nga një institucion te një institucion tjetër i QNOD; shkëmbimi efikas i informacionit ndërmjet QNOD dhe agjencive të vendeve fqinjë; rritja e aftësive në drejtimin e operacioneve kundër trafikut të jashtëligjshëm dhe ruajtjes së kufirit, në drejtim të operacioneve të reagimit ndaj ndotjeve detare; zhvillimi i gjuhës operacionale dhe komunikimit institucional dhe ndërinstytucional gjatë

kryerjes së operacioneve detare; rritja e nivelit të shkëmbimit të informacionit mes institucioneve dhe me vendet partnere, etj. Në kuadër të transparencës së zhvillimit të veprimtarive të këtyre llojeve, së afërmi për këtë stërvitje do të zhvillohet dhe Dita e Vizitorëve të Shquar. Në përfundim të kësaj stërvitjeje, të gjithë pjesëmarrësit e institucioneve do të jenë në gjendje të analizojnë situata, të marrin vendime sa më të sakta për zgjidhjen e situatave të mundshme problematike të krijuara dhe zbatimin e ligjit në det.

Konsolidohen programet e bashkëpunimit me Gardën e New Jersey-it

Zhvillohet aktiviteti “Support for commissioning program TCT” zv/ko-mandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, pret në një takim kortezie ekipin amerikan të Gardës së New Jersey

Në kuadër të zbatimit të programit pilot të arsimit të oficerëve të rinj që aktualisht po zhvillohet në institucionin e KDS (AFA), për një periudhë pesëditore një ekip trajnues amerikan i gardës së New Jersey, zhvilloi këtë javë aktivitetin “Support for commissioning program TCT”. Ekipit amerikan i kryesuar nga nënkolonel William Bono, ju rezervua një pritje e veçantë nga zëvendëskomandanti i KDS-së kolonel Ruzhdi Kuçi. Në këtë takim morën pjesë shefi i Zyrës së ODC major Christopher Mitchell, shefi i Shtabit i KDS-së kolonel Riza Zaja, Dekani i Fakultetit të Arsimit të Përgjithshëm i AFA-së kolonel Edmond Braneshi si dhe shefi i Degës së Arsimit dhe Stërvitjes në KDS, nënkolonel Shpresim Shllaku. Kolonel Kuçi pasi uroi mirëseardhjen, ndër të tjerash theksoi: “Është hera e parë që ne kemi një program kaq madhor në fushën e arsimit ushtarak. Me eksperiencën e ekipit amerikan trajnues do të shkojmë më përpara edhe në aspektin cilësor, ne jemi optimist për këtë dhe dëshirojmë që në të ardhmen ky lloj programi të vazhdojë jo vetëm me personelin e oficerëve të rinj, por edhe me personel nënoficer të FARSH. Gjithashtu ky program vjen në kohën më të përshatshme dhe me impakte tepër pozitive për të gjithë procesin e arsimit ushtarak, duke qenë se aktualisht jemi në fazën e rishikimit të këtij procesi në të gjithë fushën e mbrojtjes. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, si institucioni kryesor i sistemit të edukimit, arsimit dhe trajnimit të FA, mban peshën kryesore në aplikimin dhe realizimin e këtij programi”. Në përfundim, kolonel Kuçi shprehu angazhimin maksimal të së gjithë strukturave arsimore, në mbështetje efikase të realizimit me sukses të së gjitha fazave të programit trajnues, përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të tij. Nga ana e tij, shefi i Zyrës së ODC major Mitchell, pasi falënderoi të gjithë stafin drejtues dhe mbështetës të palës shqiptare në realizimin e këtij programi, si dhe për atë çka është bërë deri tani, e vuri theksin në forcimin e marrëdhënieve midis dy palëve si dhe në krijimin e lehtësirave në punën e përbashkët dhe në rritjen e efikasitetit të këtij programi. Më pas, ekipi amerikan nëpërmjet një prezantimi të mbajtur në Fakultetin e Arsimit të Përgjithshëm për “Sistemin arsimor dhe programi pilot I oficerëve të rinj”, u njoh me gjendjen aktuale të zhvillimit të kursit, masat e marra nga ana e institucionit të KDS dhe strukturave të varësishme të saj, në drejtim të përzgjedhjes së trupës së instruktorëve dhe kandidatëve pjesëmarrëse në këtë program, hartimit të programit trajnues, masat mbështetëse logjistike e infrastrukturale për akomodim, jetesë, përgatitje fizike e bazë materiale didaktike e kancelerike. Ekipi amerikan, në ditë në vijim do të vëzhgojë nga afër zhvillimin e stërvitjes.

Nënkolonele Alda Sula

Shkolla e Trupës, prioritet maksimal anglishtes

Në datën 17.01.2014 në Shkollën e Trupës filloi kursi i gjuhës angleze niveli i parë, me dy grupe mësimore me nga 16 ushtarakë secili grup, kryesisht oficerë, nënoficerë dhe ushtarë profesionistë ne dy grupe mësimore nga Shtabi i SHT, Departamenti i Luftimit, kompania e mbështetjes dhe kompanitë SIB e SIA. Kursi i gjuhës angleze niveli i parë në njësi është organizuar dhe funksionon që nga viti 2007 e në vazhdim, kjo falë edhe bashkëpunimit të shkëlqyer që kemi pasur dhe kemi me Qendrën e Gjuhëve të Huaja në KDS. Te gjitha pajisjet e dy laboratorëve me kapacitet 32 vendesh dhe literatura përkatëse janë dhuratë e palës amerikane dhe e kontributit të paçmuar të QGHJ, ndër vite. Laboratorët e gjuhës angleze në Shkollën e Trupës janë të pajisura me të gjithë bazën materiale të nevojshme, për mësim, dëgjim dhe për punë të pavarur nga vetë kursantët. Kursantëve u janë krijuar kushtet optimale jo vetëm për të studiuar, por edhe për zhvillimin e punës së pavarur në bibliotekën e pasur të Shkollës së Trupës, etj. Aktualisht si instruktorë të gjuhës angleze në këtë kurs janë aktivi-

zuar, personeli i SHT të cilët përveç punës së tyre në detyrat funksionale do të japin kontributin e tyre në rolin e instruktorit të gjuhës angleze, si gjuha operacionale e NATO-s. Nga ky personel mund të përmendim nënkolonel Sokol Mehmeti, nënkolonel Flori Çela, toger Arjon Kondaj, nëntoger Ervis Mazaj, rreshter Leonard Barxhaj, tetare Elona Vranaraj, nëntetare Entela Gjokaj, të cilët janë të kualifikuar e certifikuar në nivele më të larta në QGJH, në DLI-USA, universitete brenda dhe jashtë vendit, etj, të cilët me pasionin e përkushtimin e tyre kontribuojnë në mësimin e gjuhës së huaj për kolegët e tyre në këtë institucion arsimor dhe stërvitor. Në hapjen e këtij kursi Komandanti i SHT-se kolonel Agim Shahu, duke uruar personelin pjesëmarrës vuri theksin tek rëndësia që paraqet mësimi i gjuhës së huaj, përfshi përkushtimin e gjuhës operacionale të NATO-s, kryesisht për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionist. Në këtë kontekst kërkohet intensiteti i lartë dhe impenjim i vazhdueshëm si nga kursantët dhe instruktorët, përfshirë dhe punën në grup me punën individuale, disiplinë dhe monitorim rezultatesh. Vetëm kështu mund të sigurojmë cilësinë dhe “selektimin” objektiv të aftësive për

gjithsecilin. Më tej, kolonel Shahu vijoi se: Gjuha angleze përbën elementin bazë fillestar, të një fushe, konkretisht asaj të arsimit dhe bashkëpunimit me kolegët tanë të NATO-s dhe duke njohur dhe aplikuar këtë gjuhë të domosdoshme ne jemi në gjendje të ndërveprojmë si të barabartë me ato, të shkëmbejmë idetë dhe eksperiencat tona si dhe të aplikojmë në kurrikulat tona arsimore dhe stërvitore të rejt më të fundit nga institucionet më prestigjioze të shkollave të trupës së vendeve të NATO-s. Ne rastin konkret gjuha angleze përbën një detyrim të padiskutueshëm, që secili duhet të zotërojë aftësitë e duhura sipas gradave dhe vendit të punës. Në të njëjtën kohë është detyrim që krahas gjuhës së folur, të sigurohet dhe përkushtimi i njohuritë në gjuhën operacionale për secilin specialitet, që shkolla e trupës e ka edhe si një nga detyrat kryesore të listës së misionit të saj. Gjuha angleze edhe në të ardhmen, mbetet një ndër prioritet më të rëndësishme për vlerësimin e kuadrit ushtarak të së gjitha niveleve, prandaj duhet t'i kushtohet një rëndësi edhe më e madhe nga i gjithë personeli ushtarak dhe civil i SHT. Në kursin e nivelit të parë të gjuhës angleze prioritet i është dhënë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë të

cilët posedojnë rekorde të mira për vijueshmëri në promovimin e tyre në gradë dhe karrierën e ardhshme ushtarake. Zhvillimi i këtij kursi ka si qëllim që t'i shërbejë personelit që dëshirojnë të përvetësojnë gjuhën angleze dhe është i dedikuar të ofrojë instruksione, si dhe mundësitë më të mira të praktikimit të kësaj gjuhe duke përdorur materiale dhe teknika të metodologjisë amerikane dhe eksperiencës tonë në vite të QGJH të FARSH. Në përfundim të kursit të nivelit të parë, gjithë kursantët do të monitorohen e testohen nga një ekip pedagogësh nga QGJH të FARSH, sipas testit ALCPT dhe STANAG-6001. Programet mësimore e didaktike të kursit janë mbështetur dhe njësuar me programin mësimor të QGJH të FAsë, sipas nivelit 1111 të kësaj qendre, udhëzimeve të herëpashershme prej tyre si dhe të ShShPFA për zhvillimin e kurseve të këtyre niveleve fillestare nga vetë njësitë dhe repartet e FA. Kursi do të përfundojë më datë 20.04.2014 dhe në përfundim të tij shpresojmë të arrijmë një rezultat të kënaqshëm me të gjithë personelin pjesëmarrës, si dhe të vijojmë këtë eksperiencë edhe në 6-mujorin e dytë të këtij viti arsimor e stërvitor.

Tetare Lida Demaj

Promovimi i botimeve doktrinare dhe sfidat për të ardhmen

Ditën e premte, më 14 shkurt 2014, në sallën e mbledhjeve të KDS-së u organizua promovimi i botimeve doktrinare nga Qendra e Doktrinës për vitin 2013. Në promovimin e tyre merrnin pjesë: Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Jeronim Bazo, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralbrigade Viktor Berdo, gjeneralë, kolonelë, personalitete të fushës akademike, pedagogë dhe të ftuar të tjerë. Fjalën e hapjes e mbajti zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes kolonel Ruzhdi Kuçi. Në fjalën e tij, kolonel Ruzhdi Kuçi, vuri në dukje kontributin dhe rëndësinë që kanë botimet doktrinare për të gjitha Forcat e Armatosura. Përpunimi dhe zbërthimi i mendimit doktrinar, theksoi koloneli, ka pasur përparësi në punën tonë nëpërmjet procesit të rishikimit dhe hartimit të një sërë doktrinave, koncepteve e dokumenteve bazë për funksionimin e FA-së, e parë kjo si pjesë e pandarë e parimeve dhe zhvillimit konceptual e doktrinar të Aleancës. Një ndër kontributet themelore mbetet publikimi i "Revistës Ushtarake", si i vetmi organ teoriko-shkencor i FA-së. Me publikimin e saj, është mundësuar hapësira për paraqitjen e mendimit të përparuar ushtarak, duke vlerësuar punën e bërë nga Qendra e Doktrinës për përgatitjen dhe zhvillimin e botimeve doktrinare në vitin 2013 Shefi i Qendrës së Doktrinës, kolonel Ahmet Leka, në fjalën e tij vuri theksin në ndikimin që kanë konceptet doktrinare dhe mendimi ushtarak në procesin e ristrukturimit dhe reformimit të FA-së. Tashmë ato, si një forcë e një vendi anëtar të NATO-s dhe të afta profesionalisht, duhet të mbështeten me doktrina e manuale bashkëkohore, me zhvillimin e koncepteve të rinj doktrinarë dhe me një terminologji komandimi të standardizuar, për të siguruar arritjen e ndërveprueshmërisë në operacione. Në këtë kontekst, ai u ndal në mënyrë kronologjike të puna që ka bërë Qendra e Doktrinës në lidhje me hartimin dhe publikimin e doktrinave, teksteve, manualeve dhe rregulloreve të ndryshme të nevojshme për FA. Hartimi dhe publikimi për herë të parë i Doktrinës Ushtarake (DP-01) si kreu i dokumenteve doktrinarë, pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, shënon një pikë kthese në reformimin e mendimit doktrinar dhe të gjithë ngrehinës së dokumenteve të tjera, sipas niveleve. Doktrina Ushtarake pasqyron, tashmë, konceptin e mbrojtjes kolektive; konceptin e përdorimit operacional të forcës; konceptin e përdorimit të forcës për detyrë (Task Force); konceptin e vendimmarrjes dhe çështjeve të planëzimit; konceptin e mbështetjes logjistike në situatë normale dhe në kushte operacioni; konceptin e komandim-kontrollit, etj. Krahas Doktrinës Ushtarake, ai theksoi dhe punën që bëhet në bashkëpunim me SHPFA dhe komandat e forcave për hartimin dhe zhvillimin e doktrinave të forcave dhe mjaft manuale, procedura taktike e teknike të nevojshme për strukturat e tyre. Kolonel Leka foli për rëndësinë që ka bashkëpunimi si vend aleat me NATO-n. Ndërveprimi doktrinar me Aleancën, theksoi ai, ka qenë vazhdimisht në fokusin e punës së Qendrës së Doktrinës. Ndërtimi i një kuadri doktrinar të përbashkët me NATO-n është një karakteristikë thelbësore për rritjen e



Dita e promovimit të publikimeve doktrinare ka si qëllim publikimin e një sërë botimesh doktrinare aq të nevojshme për reformimin e FA-së, në përputhje me standardet e NATO-s, duke rritur shkallën e profesionalizmit, dinjitetit dhe integritetit të saj, duke e kthyer atë në një forcë aktive në shërbim të vendit dhe të denjë për standardet e vendeve të Aleancës.

Zv/komandant i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, thekson rolin dhe domosdoshmërinë e botimeve gjatë fjalës së tij "Përvojë pozitive në zhvillimin konceptual dhe doktrinar të FA"

Jemi mbledhur sot në këtë ceremoni modeste për të promovuar disa nga publikimet dhe produktet tona për vitin 2013 të cilat për një institucion si i yni janë të shumta, të dukshme dhe të prekshme. Përpunimi dhe zbërthimi i mendimit doktrinar, ka pasur përparësi në punën tonë nëpërmjet procesit të rishikimit dhe hartimit të një sërë doktrinave, koncepteve e dokumenteve bazë për funksionimin e FA, e parë kjo si pjesë e pandarë e parimeve dhe zhvillimit konceptual e doktrinar të Aleancës. Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes nëpërmjet Qendrës së Doktrinës, si institucion që ushtron veprimtarinë kërkimore dhe studimore në interes të Forcave të Armatosura, në fushën e doktrinës, standardizimit, mësimave të nxjerra, por dhe çështjeve të tjera themelore në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë ka mundësuar përgatitjen, botimin dhe publikimin e Doktrinës Ushtarake të FARSH, si dhe dokumenteve të tjera doktrina te forcave, manuale, rregullore, STANAG, Mësimave të Nxjerra, direktiva e udhëzime, që ndikojnë drejtpërdrejtë në përfundimin e kapaciteteve dhe veprimtarisë operative të FARSH. Gjatë hartimit të tyre, është mbajtur parasysh fakti se FARSH janë forca të një vendi anëtar të NATO-s, dhe si të tilla duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me ato homologe, duke



kërkuar gjithnjë që të arrihet niveli i kërkuar i standardizimit e i ndërveprueshmërisë. Një ndër kontributet themelore mbetet publikimi i "Revistës Ushtarake", si i vetmi organ teoriko-shkencor i FA. Me publikimin e saj është mundësuar më shumë hapësirë për paraqitjen e mendimit të avancuar ushtarak, në fusha me interes të tilla si: reformimi e transformimi i FARSH.

Në këtë Revistë janë trajtuar edhe shumë çështje me rëndësi, sikurse zhvillimi i një sistemi të integruar të arsimimit e stërvitjes, konceptimit dhe zhvillimit të operacioneve të sotme e të ardhme të FARSH, të mësimave të nxjerra, të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale e financiare, probleme të ndërveprimit, të modernizimit dhe të standardizimit, të

zhvillimeve të teknikës e teknologjisë, si dhe të historisë ushtarake. Procesi i transformimit kërkon jo vetëm njohje, por edhe pranimin e ushtrimit e përparësive që e shoqërojnë atë, ndaj në të ardhmen angazhimi i parësor i QD mbetet çuarja e këtyre publikimeve të rëndësishme, por dhe atyre që do të përgatiten më pranë konsumatorit ushtarak, shtabeve të ndryshme dhe auditorëve në sistemin tonë arsimor ushtarak. Njëkohësisht, sikurse edhe në ushtritë më moderne, zhvillimi i bibliotekave elektronike për të shkuar me tej në projektin e dixhitalizimit të librit mbeten një nevojë imediate e përbashkët e jona. Qendra e Doktrinës, ka për detyrë të vazhdueshme të ngulmojnë e të punojë me mentalitetin e transformimit të vijueshëm në ndërtimin, organizimin dhe zhvillimin e mendimit teorik e doktrinar për përdorimin me efektivitet të forcës së ardhshme. Për këtë, duke shfrytëzuar më së miri përvojën pozitive të këtyre dekadave, në organizimin dhe zhvillimin konceptual të FA, në punën tonë kemi se ç'të përmirësojmë e të përsosim, kemi shumë gjëra për të bërë, mbështetur në filozofinë dhe metodologjinë e re të kërkuar dhe, në mjedisin e ri të krijuar. Kjo është përgjegjësi e jona për të ardhmen, për vazhdimësinë e sigurt të së nesërme.

ndërveprimit për operacionet me aleatët si në nivelin doktrinar, ashtu dhe në nivelin procedural. Në përfundim të fjalës së tij, shprehu falënderim dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë ata, të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, janë angazhuar, kanë kontribuar dhe bashkëpunuar në zhvillimin e projekteve tona, qofshin ata brenda apo jashtë Forcave të Armatosura. Aktiviteti vijoi me paraqitjen nga Dr. Bernard Zotaj të bashkëpunimit të Qendrës së Doktrinës me

institucionet e tjera dhe kontribuues të veçantë për përgatitjen e librave si pasuri e madhe për FA. Në fund e mori fjalën shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili theksoi se dita e promovimit të publikimeve doktrinare ka si qëllim publikimin e një sërë botimesh doktrinare aq të nevojshme për reformimin e FA-së, në përputhje me standardet e NATO-s, duke rritur shkallën e profesionalizmit, dinjitetit dhe integritetit të saj, duke e kthyer atë në

një forcë aktive në shërbim të vendit dhe të denjë për standardet e vendeve të Aleancës. Hapat kryesore për arritjen e këtyre objektivave do të fillojnë nga angazhimi dhe zotimet konkrete institucionale, përfshirë këtu edhe Qendrat studimore e shkencore për përgatitjen e dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, Doktrinës së FA, të rregulloreve e manualeve në përputhje me kushtet e reja të sigurisë dhe të mbrojtjes, të parashikuara në programin

e qeverisë 2013-2017 dhe në dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. KDS dhe Qendra e Doktrinës, theksoi gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka për detyrë të vazhdueshme të punojnë për transformimin e vijueshëm në ndërtimin, organizimin dhe zhvillimin e mendimit teoriko-shkencor e doktrinar, për përdorimin me efektivitet të forcës së ardhshme, duke shfrytëzuar më së miri përvojën pozitive të këtyre dekadave, në përgatitjen dhe zhvillimin konceptual të FA-së.



Kolonel Ahmet Leka, Shef i Qendrës së Doktrinë, flet mbi rëndësinë e koncepteve doktrinare dhe domosdoshmërinë e publikimit të tyre

QD, zhvillimi dhe reformimi i mendimit doktrinar në fokus

Procesi i ristrukturimit dhe reformimit të FA shoqërohet natyrshëm me ndryshime thelbësore të mendimit ushtarak dhe koncepteve tona doktrinare. Forcat e Armatosura, tashmë një forcë tërësisht profesionale dhe, një forcë e një vendi anëtar të NATO-s, duhet të mbështeten me doktrina e manuale bashkëkohore, me zhvillimin e koncepteve të rinj doktrinarë dhe me një terminologji komandimi të standardizuar, për të siguruar arritjen e ndërveprueshmërisë në operacione. Aleanca e Atlantikut, në publikimet e saj, po i jep një rëndësi të veçantë zhvillimit të doktrinë, procesit të standardizimit dhe sistemit të mësimave të nxjerra në përgjigje të arritjes të nivelit më të lartë të ndërveprueshmërisë midis forcave të saj në operacione. Rrethanat e reja, të krijuara në kuadrin e një mjedisi strategjik dhe operacione, gjithnjë e më kompleks dhe në ndryshim të shpejtë, kërkojnë një gatisshmëri dhe vëmendje për t'ia përshtatur këto dokumente doktrinare reagimit ndaj sfidave që paraqesin këto ndryshime në mjedisin e sigurisë. Në këtë kontekst, Qendra e Doktrinë, duke bashkëpunuar me strukturat e tjera të FA si drejtoritë në SHPFA, komandat e forcave, AFA, Agjencinë e NATO-s për Standardizimin (NSA), si dhe me strukturat homologe jashtë vendit, ka arritur të përgatisë, zhvillojë dhe publikojë një sërë dokumentesh të nivelit doktrinar, manuale, rregullore e tekste, por edhe shume të tjera në fushën e standardizimit, mësimave të nxjerra, por edhe të kërkimit e zhvillimit shkencor. Hartimi dhe publikimi për here te pare i Doktrinë Ushtarake (DP-01) si krye-kreu i dokumenteve doktrinarë, pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, shënon një pikë kthese në reformimin e mendimit doktrinar dhe të gjithë ngrehinës së dokumenteve të tjera, sipas niveleve. Doktrina Ushtarake pasqyron tashmë konceptin e mbrojtjes kolektive; konceptin e përdorimit operacionel të forcës; konceptin e përdorimit të forcës për detyrë (Task Force); konceptin e vendimmarrjes dhe çështjeve të planëzimit; konceptin e mbështetjes logjistike, në situatë normale dhe në kushte operacioni; konceptin e komandimit kontrollit, etj. Doktrina Ushtarake, si një dokument themelor i përdorimit operativ-strategjik të FARSH, pasqyron të gjithë dinamikën dhe shumëllojshmërinë e operacioneve të tashme e të ardhshme, veçmas apo në koalicion me NATO-n. Krahas Doktrinë Ushtarake, mund të themi se, në bashkëpunim me Komandën e FAJ, është përfunduar edhe Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), e cila është hartuar në përpunim me Kushtetutën dhe ligjet e RSH dhe, si e tillë, është pjesë e misionit dhe e detyrave të FARSH. Ajo është pjesë e hierarkisë së Doktrinë Ushtarake të FARSH (DP-01), si dhe në pajtueshmëri të plotë me të. Në bashkëpunim me FS është hartuar Doktrina e Forcave Speciale, e cila shpjegon me hollësi çfarë janë Forcat e Operacioneve Speciale, operacionet speciale në kuadrin e operacioneve ushtarake, objektivat e operacioneve speciale, karakteristikat e tyre, operacionet speciale dhe parimet e luftës etj. Dua të theksoj se në kuadrin të ristrukturimit të FA, me direktiva të veçanta, të miratuara nga SHSHIP po rishikohet tërë hierarkia doktrinare duke filluar nga Dokumenti themelor

DP-01, doktrinat e forcave e deri në nivelin taktik. Ndërveprimi doktrinar me Aleancën ka qenë vazhdimisht në fokusin e punës së Qendrës së Doktrinë. Përdorimi i Doktrinëve të Aleancës nuk do të synojë vetëm njësitë që marrin pjesë në operacione të drejtuara nga NATO, BE, apo koalicionet të tjera të mundshme, por do të synojë shtrirjen gradualisht të tyre në të gjitha njësitë e FA për misione kombëtare apo ndërkombëtare. Kështu kemi publikuar te shqipëruara, Doktrinë e Përbashkët të Aleancës (AJP-1), (AJP-3), (AJP-2), (AJP-5), Doktrinë e Përbashkët të Operacioneve Tokësore (AJP-3.2) etj. Në zbatim të hierarkisë doktrinare të miratuar, puna e Qendrës së Doktrinë, si një strukturë kryesore menaxhuese dhe koordinuese e këtij procesi, krahas përgatitjes së dokumenteve të nivelit të parë, ka konsistuar edhe në zhvillimin, përgatitjen dhe botimin e shumë manualeve dhe rregulloreve të ndryshme të cilat trajtojnë procedurat taktike e teknike (TTP) në nivele të ndryshme të strukturave të Forcave të Armatosura, konkretisht janë publikuar: Manuali "Skuadër-togë-kompani", manuali "Shenjat Konvencionale" manuali "Operacionet e Spekrut të Plotë", manuali "Mësimet e Nxjerra në FA", manuali "Forcat e Armatosura në Emergjencat Civile", manuali "Operacionet jo-luftarake dhe të Mbështetjes së Paqes", etj. si dhe mjaft rregullore të përbashkëta të FA si, "Rregullore e Jetës së Brendshme", "Rregullore Rreshtore", "Rregullore e Uniformave", "Rregullore e Procedurave të Botimeve Doktrinare", "Rregullore e Testit Ushtarak të Përgatitjes Fizike", etj. Një aspekt tjetër i rëndësishëm në punën e Qendrës së Doktrinë ka qenë dhe mbetet zhvillimi dhe publikimi i Revistës Ushtarake, si i vetmi organ teoriko-shkencor në FA. Revista Ushtarake ka shërbyer si një dritare e hapur për mendimin me të avancuar dhe me të kualifikuar, tribunë e mendimit akademik për tema e probleme të teorisë dhe mendimit ushtarak, të praktikës së mësimdhënies në institucionet arsimore ushtarake,

si hapësirë e domosdoshme për publikimin e punimeve studimore shkencore e doktrinare etj. Nevoja e rishikimit, përpunimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të hierarkisë doktrinare, si dhe pranimit, ratifikimit e zbatimit i STANAG/AP-ve të NATO-s, përbën një domosdoshmëri për FARSH, e cila lidhet me disa faktorë:

Së pari, ato përbëjnë një ndihmesë për rritjen e bazës teorike në procesin e ristrukturimit të thellë në Forcat e Armatosura nga pikëpamja doktrinare, konceptuale dhe strukturore, me qëllim rritjen e shkallës së mëtejshme të profesionalizimit të personelit të FA.

Së dyti, nëpërmjet këtyre publikimeve bashkëkohore, sigurohet ana teorike procedurale, ndërveprimi i FA me strukturat ushtarake euro-atlantike, sidomos në fushën e koncepteve doktrinare dhe terminologjisë së komandimit dhe kontrollit të forcave (C2).

Së treti, Realizohet reflektimi i vazhdueshëm i mjedisit gjeostrategjik dhe operacionel. Pra, Forcat e Armatosura kanë nevojë të përhershme për publikime cilësore doktrinare e ushtarake nga niveli operativ-strategjik e deri në ato të nivelit taktik e teknik të shërbimeve të ndryshme. Shpallja e integritit të FA në Aleancë, gjatë zhvillimit të Konferencën 5-të me ACT, e çon tërë procesin e zhvillimit të doktrinë dhe standardizimit në një nivel akoma edhe më të lartë. Le të shërbejë ky takim si nisim e re për përmirësimin e prioritetëve dhe objektivave për vitin 2014, për të ngritur në një shkallë më të lartë arritjet dhe synimet tona, duke e renditur këtë institucion në lartësitë që e kërkojnë interesat e mbrojtjes së vendit; vetëm kështu do të rritet edhe më shumë angazhimi ynë dhe do të përballohen më mirë sfidat që kemi përpara. Duke përfunduar, dua të shpreh falënderim dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë ata, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, janë angazhuar, kanë kontribuar dhe bashkëpunuar në zhvillimin e projekteve tona, qofshin ata brenda apo jashtë Forcave të Armatosura.

Drejtori i QLMI-së, Prof. Asc. Dr Bernard Zotaj, flet për rolin e veçantë të librit në edukimin e përsosjen e pjesëtarëve të FA

Të gjithë e dimë se libri është trashëgimi e përjetshme, e vlefshme dhe ndriçuese gjatë jetës së njeriut. Libri ka rol të veçantë, të lartë e konstruktiv në edukimin, përsosjen e individit e të shoqërisë, si dhe të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura. Nëpërmjet tyre komandantët, gjeneralët, strategët drejtuesit ushtarak e oficerët kanë arritur të bëhen të përjetshme dhe njerëz të mëdhenj në historinë botërore e shqiptare, cilët me anë të librave kanë arritur të ndikojnë në shoqëri, si dhe në FA. Të gjitha kulturat fillojnë me libra, pjekurinë njeriu e arrin me to, dhe me anë të tyre transferojnë eksperiencat për gjeneratat e ardhshme. Në këtë mes, edhe kultura e librit ushtarak ka një karakteristik të veçantë, për shkak se: që nga lashtësia i është kushtuar vëmendje, interes dhe rëndësi e veçantë dijes dhe arsimit të luftëtarëve. Studimi është konsideruar si rruga më e rëndësishme për të arritur në dije dhe shkencë, pasi libri është mjet transmetues i mesazhit, kulturës dhe civilizimit brez pas brezi. Ai është mjeti i mendimit dhe plotësues i njeriut. Me anë të këtij mjeti matet fuqia dhe potenciali i njeriut në aspektin shkencor dhe të dijes. Në epokën e sotme medias i janë shtuar mjete të ndryshme komunikimi dhe ndërlidhjeje, por libri nuk e ka humbur vlerën e tij dhe nuk është vjetërsuar kurrë. Rëndësinë e rolit të librit për mësimin e dije e dëshmojnë dhe Forcat e Armatosura nëpërmjet librave të publikuara nga QD në KDS-së. Në shkollat tona ushtarake gjithmonë është theksuar roli i veçantë në studimin e librit, për të shkruar dhe lexuar, sepse librat kanë luajtur një rol të pamohueshëm në formimin dhe plotësimin personal të ushtarakut. Ndaj e përgëzoj dhe e vlerësoj QD që i tregon kujdes promovimit të vlerave të librave të botuara në vitin 2013, por dhe vite më parë. Librat të tillë si: Konferenca shkencore me rastin e 100 vjetorit të FA; trajton të gjitha materialet e kësaj konference në gjuhën angleze, me autorë shqiptarë dhe të huaj. "Vështrim mbi Artin Ushtarak Botëror" të Prof. Dr. Shahin Leka; është një libër me vlera të rralla për historinë ushtarake botërore deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. E veçanta se arti ushtarak botëror trajtohet në një këndvështrim të ri mbi bazën e literaturës së re të botuar nga personalitete botërore, propagandistë të saj. "Koncepti strategjik ushtarak shqiptar 1945 – 1991", të Kol. Dr. Ahmet Leka; libër me kërkesa ndaj kohës dhe i prurë me kujdes të veçanta për një trajtesë të tillë siç edhe është koncepti strategjik ushtarak, në veçanti ai shqiptar. Teksti "Etika ushtarake dhe arti i komandimit", të autorëve Kol. (r) Guri Pashaj, Kol. Dr. Ahmet Leka, Gjeneralbrigade Bardhyl Hoxha, MSc. Valbona Zeka; përcakton etikën ushtarake dhe jep artin e komandimit për t'u përvetësuar dhe përfaqësuar tek figura e ushtarakut. Teksti "Siguria e shteteve të vogla", ta autorëve Kol. Dr. Eduart Bala, Gjeneralmajor (r) Prof. Dr. Ruzhdi Gjatajo, Kol. (r) Doc. Selim Shiroka; një tekst i kohës që AFA dhe çdo ushtarak duhet ta njohë dhe përvetësojë. Libri është pjesë e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare që çdo ushtarak, por në veçanti ata që marrin pjesë në operacionet e NATO-s, duhet të njohin në perfeksion. Teksti "Operacionet kundër-kryengritëse (COIN)", të autorëve Kol. Riza Zaja, N/kol. Dëfrim Haxhijaj, N/kol. (r) Doc. Agim Gjini; jep një panoramë të operacioneve kundër-kryengritëse dhe pasqyron një përvojë të kohëve të fundit në operacionet në kuadrin të bashkëpunimit me NATO-n. Katalogu i QD të autorit Kapiten Lejtant Armand Llazari, trajton misionin, vizionin, përgjegjësitë, detyrat dhe synimet e kësaj qendre për të ardhmen. E veçanta e tyre, këtë vit, për të gjitha librat e botuara nga QD, është se janë sipas standardeve dhe të pajisura me ISBN, kërkesë e kohës. Natyrshëm për librin, mendja të shkon tek shtëpitë e botimit, tek shkriarët, tek përthyesit dhe tek të gjithë intelektualët ushtarakë dhe atyre civilë që përipiqen në fushën e librit dhe të leximit. Por, nga një studim i kryer në reparte dhe njësi të FA, del se për librin e kujdesin ndaj tij, duhet të bëjmë më shumë veprimtari kulturore, si dhe organizime të ditëve e të javëve të punës me librin. Koha kërkon që shkollat ushtarake, por dhe njësi e reparte të organizojnë më mirë panairë të librit, rregullim e sistemin të bibliotekave, si dhe zhvillim të simpoziumeve e aktivitetëve të ndryshme për të rritur pozitën e librit në FA. Ndër veprimtaritë e organizuara në vitin që shkoj mund të përmendim zhvillimin e promovimeve të librave të botuara nga pedagogë dhe profesorë të AFA. Të tilla veprimtari kanë qenë ato të organizuara për librat e Dr. Simon Gega, Prof. Dr. Proletar Hasani, Dr. Marenglen Kasmi, Dr. Jaup Zenuni etj. Të gjithë këta libra përbëjnë vlera të shtuara për FA, për institucionin e AFA, por dhe për bibliotekat tona. Për këtë vit e në vazhdim, mbi bazën e përvojës, të traditës dhe të risive të kohës, kërkohet që punën me librin dhe me bibliotekat, deri tek biblioteka dixhitale, ta organizojmë më mirë dhe të jemi të vëmendshëm ndaj tij.

"Revista Ushtarake", shprehje e mendimit të përparuar doktrinar

Silvana Markgjonaj, redaktore e RU, bën një paraqitje të shkurtër të organit teoriko-shkencor "Revista Ushtarake", si shprehje e mendimit të përparuar doktrinar dhe pjesë e vlerave të FA

Revista Ushtarake, organ i vetëm teoriko-shkencor dhe shprehje e mendimit të përparuar doktrinar të FARSH, me dimension ndërkombëtar dhe e vlerësuar nga institucione kombëtare e ndërkombëtare të sigurisë, miratuar nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor, pranë Këshillit të Ministrave, me Vendim Nr. 4, datë 10.12.2003. "Revista Ushtarake" është e vetmja revistë shkencore në Forcat e Armatosura. Si e tillë, kjo revistë respekton kërkesat dhe parametrat shkencorë të shkriemeve e botimeve të saj, sipas standardeve. "Revista Ushtarake" synon të arrijë nivelet e revistave simotra të vendeve të tjera të Aleancës Euroatlantike. Gjatë vitit 2013, RU, e botuar në tre numra në gjuhën shqipe dhe dy numra në gjuhën angleze, ka trajtuar mjaft problematika bashkëkohore me zhvillimet në FA. Ajo ka trajtuar, në rubrika të veçanta, tematika në interes të zhvillimit të reformës së mbrojtjes, nxitjes së debatit për çështje themelore të zhvillimit e transformimit të institucionit të mbrojtjes, të menaxhimit të çështjeve themelore të FA, të zhvillimit të koncepteve

dhe të doktrinëve, të arsimimit dhe stërvitjes, të operacioneve kombëtare e ndërkombëtare, të përmirësimit të kapaciteteve operacionale të njësitë të FA, sipas standardeve të NATO-s dhe vendeve anëtare të saj. Historia ushtarake, zhvillimi i mendimit ushtarak në shekuj, bibliografi, strategj e gjeneralë shqiptarë e të huaj, zbërthime temash, recenca, etj. gjejnë gjithashtu pasqyrim në RU. QD, në zhvillimin e këtij projekti, bashkëvepron ngushtë me akademitë e shkollat ushtarake, me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA, komandat kryesore si dhe me institucione ushtarake e civile simotra, brenda e jashtë vendit. Revista është e hapur për ushtarakë, përfaqësues të shoqërisë civile, ushtarakë në rezervë, veteranë e pensionistë. Në të kanë shkruar personalitete të fushës së sigurisë e mbrojtjes, brenda dhe jashtë vendit, si ministra, zv/ministra, ambasadorë, akademikë, profesorë, studiues, etj. "Revista Ushtarake" është e hapur dhe pranon debatin shkencor, afishon progresin ushtarak shkencor, pasqyron veprimtari të ndryshme si konferenca shkencore, veprimtari të organizuara brenda dhe jashtë vendit, arritjet në

fushën e teknologjisë dhe informacionit. Gjithashtu, ajo është e hapur për vendet partnere, fqinje e mike. Në themel të punës për botimin e "Revistës Ushtarake" është cilësia akademike, serioziteti shkencor dhe profesionalizimi. Dorëzimi i materialeve nga bashkëpunëtorët dhe pranimit i tyre bëhet sipas kërkesave e standardeve të përcaktuara. Nuk pranohen ato materiale që nuk përmbajnë cilësi akademike, nivel studimor e kërkimor si dhe parametrat teknikë të botimit. Në fund të çdo numri, bëhet përmbledhja e çdo artikulli në gjuhën angleze në mënyrë që edhe lexuesi i huaj të njihet me problematikën e trajtuara në çdo numër të revistës. Në ndihmë të kësaj, vjen edhe botimi i "Revistës Ushtarake" në anglisht, dy herë në vit, ku përzgjidhen shkrimet me tematikat më të spikatura. "Revista Ushtarake" shpërndahet dhe konsumohet kryesisht në rrethet intelektuale të FA, por ndiqet edhe nga një audiencë më e gjerë, brenda e jashtë vendit. Jeni të mirëpritur për të kontribuar, me mendimet tuaja, në zhvillimin dhe konsolidimin e këtij projekti shumë ambicioz.

“Kapiten Feti Vogli shkëlqeu në pasionin e tij për punën dhe për këtë gëzoi respekt dhe besim nga të gjithë kolegët dhe bashkëluftëtarët e tij. Gjatë gjithë kohës së shërbimit të tij, atë e karakterizonte përkushtimi i lartë ndaj detyrës.”



Përkujtohet 2-vjetori i rënies së Dëshmorit të Atdheut, kapiten Vogli

Ministrja Kodheli: Kapiten Fetiu la pas veprën e tij që vështirë se do të mund të harrohet; ai është tashmë pjesë e memories tonë kombëtare

Në mjesditet e Batalionit të Forcave Speciale në Zall-Herr është zhvilluar në datën 20 shkurt 2014, një ceremoni përkujtimore në nderim të 2-vjetorit të rënies në krye të detyrës gjatë misionit “Eagle-4” në Kandahar, Afganistan, të Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli. Në këtë ceremoni morën pjesë ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura, familjarë dhe të afërm të kapiten Feti Voglit, si dhe të ftuar të tjerë. Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, duke përshëndetur në këtë ceremoni përkujtimore, u shpreh se, nderimi për kapiten Feti Voglin është nderim për atdheun, lirinë dhe vlerat e saj. Kapiten Feti Vogli shkëlqeu në pasionin e tij për punën dhe për këtë



gëzoi respekt dhe besim nga të gjithë kolegët dhe bashkëluftëtarët e tij. Gjatë gjithë kohës së shërbimit të tij, atë e karakterizonte përkushtimi i lartë ndaj detyrës. Më tej gjatë fjalës së saj, ministrja Kodheli u shpreh se kapiten

Fetiu la pas veprën e tij që vështirë se do të mund të harrohet, ai është tashmë pjesë e memories tonë kombëtare. Më pas, në emër të familjarëve të tij, ka folur vëllai i kapiten Feti Voglit, i cili shprehu falënderimet më të sinqerta për Minis-

trinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe komandën e Batalionit të Forcave Speciale, të cilët i janë gjendur gjithmonë pranë familjes së tij, si dhe për nderimet që i kanë bërë dhe i bëjnë Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli. Në

përfundim të ceremonisë ministrja e Mbrojtjes, Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral Bazo bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule pranë bustit të Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli.

Ndodhi ajo që Fetiu nuk priste...

Dialogu i fundit në FB i Kapiten Feti Voglit me të shoqen, një ditë para se të binte në krye të detyrës:
Vogli Voggli: Nuk kam ballin tim, kam ballin e çunave se mua nuk më gjen gjë.

Egi Vogli Egi: Ok. Më shkruaj nesër kur të dalësh, të dua shumë, të uth fort.

Vogli Voggli: Ok. Do të shkruaj unë. Ju uth fort. Të dua shumë. Natën.





Fjala e komandantit të BFS, nënkolonel Qazim Hoxha

“E ndjejmë se mes nesh mungon diçka e madhe... kolegu ynë më i mirë”

Ju falënderoj për prezencën tuaj në këtë ceremoni përkujtimore mjaft të rëndësishme për të gjithë ne, dhe si komandanti Batalionit të Forcave Speciale ndihem me të vërtetë i emocionuar dhe me zemër të thyer, që kapiten Feti Vogli, sot nuk është më fizikisht midis nesh. Jemi mbledhur të gjithë këtë mëngjes, për të nderuar kujtimin e djalit, vëllait, bashkëshortit, babait, shokut dhe kolegut tonë më të mire, dëshmorit tonë të kombit, kapiten Feti Vogli, i cili ra në krye të detyrës në misionin luftarak në Afganistan, në atë vend të largët, në emër të vendosjes së paqes, lirisë dhe demokracisë, në një vend ku kjo paqe, liri dhe demokraci mungon. Sot, dy vite më vonë, nga ajo ditë e zezë, kemi ardhur në këtë shesh- për të nderuar figurën e tij. Sot është dita përkujtimore, ku të gjithë së bashku, ne nderojmë kujtimin e dëshmorit të kombit kapiten Feti Vogli, atij ushtaraku të denjë të Forcave të Armatosur dhe Batalionit të Forcave Speciale, i cili nuk nguroi të jepte as jetën për paqen dhe lirinë e popullit Afgan. Tashmë kaluan dy vite, që kur



jeta e kapiten Feti Voglit u shua. Kjo ditë na mbledh së bashku për ta kujtuar me mall dhe respekt Kapitenin. E ndjejmë se mes nesh na mungon diçka e madhe, që asgjë s'mund ta zëvendësojë. Ai ishte shoku dhe kolegu ynë më i mirë, dhe vazhdon të ruhet gjithmonë

në zemrat tona si i shtrenjtë. Emri dhe kujtimi i tij është i skalitur në shpirtin dhe mendjen tonë. Kapiten FETIU, u largua nga kjo jetë shumë shpejt, duke lenë familjen, njerëzit e tij më të dashur, miqtë dhe kolegët me dhimbje të madhe në zemrat e tyre. Familja, humbi nje-

riun më të dashur e më të shtrenjtë, ndërsa ne humbëm shokun dhe kolegun tonë më të mirë. Batalioni i Forcave Speciale humbi kapitenin, liderin më të përkushtuar, më të përgatitur dhe më të aftë. Shumë prej nesh, kemi kujtime të bukura e të paharruara me Fetin, si në jetën e përditshme, po ashtu edhe në misione e detyra jashtë vendit. Sot, ne kujtojmë të gjitha ato gjëra të thjeshta që kemi lënë prapa, vite shkolle, pune së bashku me Kapitenin, te cilat në kujtesën tonë, na japin një paraqitje të shkurtër të jetës që ndamë me të. Dhe natyrisht, disa nga gjërat e thëna këtu, kanë domethënie të veçantë për familjarët, drejtuesit, shokët, vartësit dhe kolegët e dëshmorit. Tek secili nga ne, do të mbeten si imazhe të paharruara momentet e spikatura që ai na ka dhuruar gjatë punës me të. Gjithmonë do ti kujtojmë fjalët e sinqerta dhe shakatë e pafundme të tij, mbështetjen dhe ndihmën e pa kursyer ndaj vartësve dhe kolegeve. Fetiu kishte zemrën, krenarinë dhe vendosmërinë për të bërë më të mirën në këtë jetë për veten, familjen dhe për kombin e tij. Kjo ishte ajo që e karakterizonte kapiten Voglin. Ai ishte

një hero i vërtetë dhe kurrë nuk do të harrohet. Për familjen e dëshmorit të kombit kapiten Feti Vogli, unë e di se plagët e kësaj humbje janë të thella, por do t'ju qëndrojmë gjithmonë pranë për tua lehtësuar sadopak këtë dhimbje. Jam i sigurt se çdo brez i ardhshëm që do të vijë, do të mësojë historinë e shërbimit të trupave tona në misione jashtë vendit, do të respektojnë dhe vlerësojnë kujtimin e dëshmorit tonë të kombit kapiten Feti Vogli. Sot, të gjithë ne duhet të jemi më të fortë dhe dhimbjen për dëshmorin e kombit Fetih Vogli duhet ta kthejmë në forcë e vullnet për të ndjekur e vazhduar rrugën e nisur dhe të lënë të pa përfunduar nga Ai. Dhe së fundmi, në këtë përkujtimore dhe të gjitha vitet që vijnë, do ta kujtojmë me shumë respekt dhe krenari heroin e kombit. I paharruar qofte kujtimi i dëshmorit tonë të kombit kapiten Feti Vogli!

Zoti e Bekoftë familjen e dëshmorit! Zoti i Bekoftë burrat dhe gratë tona në uniformë dhe personelin tonë në misionet në Afganistan e kudo në botë! Zoti e Bekoftë Shqipërinë!



Fotot: Sekuenca nga dokumentari "Dëshmori i paqes, Feti Vogli", prodhim i QKMBM, të cilat japin aktivitetin e Fetit gjatë karrierës si ushtarak

Vizitë e ekipit vlerësues së Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (EUCOM-it), në BrMR

Ekipi i EUCOM-it, vlerëson punën e BrMR-së

Në datën 12.02.2014, ora 10:30, ekipi vlerësues i Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (EUCOM) kryesuar nga zoti Lonnie Carlson, vizitoi Brigadën e Mbështetjes Rajonale, ardhur në Shqipëri për një vlerësim ndërqeveritar. Qëllimi i vizitës ishte njohja me kapacitetet operationale në përballimin e emergjencave civile të BrMR-së dhe, si dhe bashkëpunimi i Brigadës me struktura të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare. Ekipi i uroi mirëseardhjen komandanti i Brigadës së Mbështetjes Rajonale gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa, i cili shprehu falënderimin mbi bashkëpunimin shumë të afërt midis dy vendeve tona si dhe ndihmesën e madhe që ka dhënë dhe po jep SHBA në

fushat kryesore të FA. Në pritje të ekipit merrnin pjesë zëvendëskomandanti i njësisë kolonel Fatmir Lokaj, komandantët e reparteve vartëse, shefi i Degës Operacionale e Stërviutjes kolonel Petrit Dajlani, dhe disa shefa Degësh në shtabin e BrMR. Gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa në vijim e njohu me strukturën e BrMR-së dhe me angazhimin aktual të njësisë, kryesisht në ndihmë të komunitetit dhe në përmirësimin e infrastrukturës në strukturat të FA. Duke pasur në konsideratë që BrMR është një nga strukturat e vetme të specializuara në përballimin e emergjencave civile por edhe në kryerjen e operacioneve humanitare, në ndihmë të komunitetit, eksperiencia e kësaj brigade është e veçantë dhe mjaft e vlerësuar.

Takimi vijoi me një brifing njohës dhe informues për ekipin vlerësues të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (EUCOM), i cili u prezantua nga kapiten Orges Baholli Specialist për Standardizimin në Degën e Planifikimit. Në brifing pjesëmarrësit u njohën me historikun e njësisë, misionin, detyrat strukturën përkatëse, personelin dhe pajisjet që disponon dhe angazhimet në fusha të ndryshme të njësisë, stërviutjes e zhvilluara, kompletimin me pajisje etj. Në përfundim të vizitës komandanti i BrMR gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa, shoqëroi ekipin amerikan. Në ambientet e stërviutjes të kompanisë së parë batalionit të kërkim shpëtimit si dhe në ambientet e depove ku mbahen teknika dhe materialet



që përdoren në Emergjencat Civile. Në emër të ekipit vlerësues të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (EUCOM), zoti Lonnie Carlson, shprehu falënderime për mikpritjen

dhe informacionin e ofruar dhe njëkohësisht vlerësoi arritjet e BrMR. Ai theksoi se ndihmesa dhe bashkëpunimi do të vijojë dhe në të ardhmen.

Mimoza Metko

Anije të SNMCMG2 vizitojnë portin e Vlorës

Në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Komandën Detare të NATO-s, nga data 14 deri më 17 shkurt 2014, anije të grupit të gatshëm SM-CMG2 zhvilluan një vizitë portuale në portin e Vlorës. Ky grup përbëhet nga dy anije minaheqëse, "FGS RHEIN", (A513) dhe "ITS CHIOGGIA", (A5560). Mëngjesin e datës 14 shkurt dy minaheqëset u futën në gjirin e Vlorës ku u pritën nga anija jonë patrulluese P-03 me komandant kap.lt. Mario Miftari. Fillimisht në molin e portit të Vlorës u bregëzua Minaheqësja "FGS RHEIN" dhe pastaj "ITS CHIOGGIA" të cilat u pritën nga një grup kuadrosh e specialistësh të Flotiljes detare, Kapitenerisë së portit dhe Autoritetit portual Vlorë. Më pas drejtuesit e grupit SMCMG2 dhe anijeve pjesëmarrëse zhvilluan takime me drejtues të Flotiljes, pushtetit qendror e vendor të Vlorës. Në Flotiljen Detare të Pashalimanit ushtarakët e NATO-s u pritën nga komandanti i Flotiljes kapiten i rangut të I-rë Subi Zenela, i cili mbasi i uroi mirëseardhjen kolegëve të NATO-s vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm midis Forcës sonë Detare dhe komponentit detar të NATO-s nga Napoli në Northwood. Ndërkohë komandanti i grupit SNMCMG2, Matthias Seipel falënderoi mikpritjen e autoriteteve shqiptare dhe theksoi se qëllimi i vizitës është jo vetëm forcimin e paqes dhe sigurisë detare, bashkëpunimin me vendet anëtare të NATO-s për këto çështje, por dhe shkëmbimi i kulturave, eksperiencave dhe



miqësisë midis tyre. Në këtë kuadër promovimi i atyre vendeve që janë anëtarësuar së fundmi në aleancë, ka rëndësi për ne, tha kapiteni Seipel. Ndaj ky grup ka kryer një lundrim të gjatë nga Deti i Kuq, në Battum e Sevastopol për tu bregëzuar në portin e Vlorës. Në bashkinë e qytetit të Vlorës ushtarakët e NATO-s u pritën nga n/kryetari i saj, zoti Arben Beqiraj i cili i informoi miqtë me vlerat historike, resurset turistike dhe ekonomike të këtij qyteti, por dhe projektet që do realizohen së afërmi. Ndërkohë gjatë takimit në prefekturën e Vlorës, prefekti i këtij qyteti zoti Besnik Dervishi shprehu kënaqësinë për vizitën e anijeve të NATO-s në portin

e Vlorës dhe theksoi qëndrimin konstant dhe angazhimin e qeverisë shqiptare për çdo program e detyrim në kuadër të aleancës. Gjatë takimeve kapiten Matthias Seipel vlerësoi mikpritjen e autoriteteve dhe popullit të Vlorës dhe respektin për vendin tone, si vend i ri anëtar i NATO-s. Në pritjen e organizuar në anijen "FGS RHEIN", Commander Matthias Seipel i informoi pjesëmarrësit me misionin dhe qëllimin e grupit të gatshëm SNMCMG2, i cili ka në përbërje anije minaheqëse nga Gjermania, Greqia, Italia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Komanda e grupit ndërrohet çdo vit, dhe për vitin 2013-2014, këtë komandë e ka Gjermania.

Grupi ka në përbërje Minaheqëse të tipeve të ndryshme, të cilat lundrojnë dhe trajnohen së bashku, zhvillojnë operatione reale së bashku, siç është operacioni "Active Endeavour", ku është e angazhuar dhe Forca jonë Detare. SNMCMG2 kryen vizita të përbashkëta në vende anëtare dhe partnere të NATO-s, jo vetëm për forcimin e elementëve të sigurisë detare por dhe për të nënvizuar solidaritetin e aleancës dhe për forcimin e marrëdhënieve miqësore e diplomatike me këto vende. Gjatë gjithë vitit SNMCMG2, operon normalisht në Detin Mesdhe dhe ato përreth si Det i Zi dhe i Kuq. Çdo ditë ushtrohen të gjitha aspektet e detajet e

luftës kundër minave detare. Me personel të aftë profesionalisht për këtë lloj lufte, grupi merr pjesë në stërviutje te ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Motoja e këtij grupi është forcimi i sigurisë në detet ku ushtron aktivitetin e tij, duke gjetur dhe asgjësuar mina dhe municione të periudhave të ndryshme historike, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta; mbajtjen e gatishmërisë së përhershme dhe bashkëpunimit me partnerët në kuadër të Aleancës së NATO-s. Gjatë këtij takimi Drejtori i Autoritetit të portit Vlorë, zoti Xhevair Çeloalaj u shpreh për median ushtarake se: vizita e këtij grupi ka rëndësi për gjithë zonën e Vlorës, ndaj ne si Autoritet Portual në vijimësi do risim cilësinë e shërbimit e sigurisë ndaj këtyre anijeve nëpërmjet projekteve për modernizimin e portit të Vlorës, të cilat do realizohen së shpejti. Koordinatori i Forcës Detare për këtë vizitë, kapitenlt. Arbër Çela na sqaron se gjatë këtyre ditëve dhe ekuipazhet e anijeve mike zhvilluan një sërë aktivitetesh të përbashkëta, vizita në objekte historike dhe muzeale në qytetin e Vlorës, si Kalaja e Kaninës, por dhe aktivitete sportive me efektivat e Flotiljes së Pashalimanit. Në orën 10.00 të datës 17 shkurt anijet e SNMCMG2 u larguan qetësisht nga ujërat tona të përcjella përsëri nga anija patrulluese Archange, P-03 me kap.lt Mario Miftari dhe ekuipazh n/officerët Fatmir Aliaj, Bardhyl Hysenaj dhe Mentor Kovaci.

Kap.Lejtnant Leonard Bidaj

BrMR, angazhim serioz në operacionin e pastrimit

Në datën 15 shkurt 2014, në zbatim të urdhrat të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA "Për pjesëmarrje në aktivitetin që zhvillohet për nismën "Shqipëria është e të gjithëve ta mbajmë atë të pastër", Brigada e Mbështetjes Rajonale ka vijuar angazhimin dhe kontributin e saj për pastrimin në aksin rrugor Kamëz - Rubik dhe Aksi Rubik - Milot. Në këtë operacion punuan forca dhe mjete të batalionit të kërkim shpëtimit dhe batalionit të xhenios. Komanda e Brigadës së Mbështetjes Rajonale dhe Komandantët e reparteve morën masa të plota për sigurimin e mjeteve të punës, dhe të personelit

efikas për të pasur një angazhim sa më me rendiment. Puna u përqendrua në pastrimin dhe sistemimin e mbeturinave inerte dhe transportimin e tyre në pikat e grumbullimit. Në Aksin Kamëz Ura e Niklës dhe Milot - Rruga e Kombit u angazhuan 5 mjete me 32 efektive. Në këtë aks u punua për ngarkim transport mjete urbane dhe mbetje inerte 48 m3, dhe nivelim terreni 200 m2. Në Aksin Milot- Rruga e Kombit, punuan 2 mjete dhe 25 forca. Efektivët u angazhuan në mbledhje - ngarkim mbetjesh urbane në sasi 8 m3 në një distancë prej 8 km. Në Aksin Rubik - Milot u angazhuan 6 mjete dhe 35 efektive. U krye ngarkim

transport mbetjesh urbane 30 m3, shtyrje nivelim dheu 300 m3. Mbetjet u shkarkuan në "landfill"-in e Halilajt. Në vazhdim në rrugën nacionale janë angazhuar 4 mjete dhe 28 forca. U krye mbledhje grumbullimi ngarkimi i mbetjeve urbane me krahë dhe transporti i 8 m3 mbetje në aksin 4 km. Forcat e angazhuara në pastrimin e akseve u inspektuan nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti i Brigadës së Mbështetjes Rajonale gjeneral-brigade Muhamet Buçpapa.

M. Metko



“Strategjia e Sigurisë Kombëtare” dhe pasqyrimi i saj te “Siguria Njerëzore”

KOLONEL (R) ZAIM KUÇI

Republika e Shqipërisë, e ndodhur në tranzicion për gjatë dy dekadave ka përgatitur dhe rishikuar Strategjinë e Sigurisë, Strategjinë Ushtarake dhe dy herë Rishikimin e Mbrojtjes. Si rrjedhojë të mos kohezionit në përgatitjen e tyre, këto dokumenta janë shoqëruar me bërje dhe çbërje të shpeshta të politikës së mbrojtjes, reformash, strukturash, qëndrimesh etj, secila i ka realizuar ndryshimet sipas kohës së përgatitjes së tyre.

E përgjithshmeja e këtyre dokumentave ka qënë moskoordinim midis tyre në afate kohore, si pasojë kanë sjellë çvlerësimin e njëri nga tjetra. Më tepër se kaq, ky moskoordinim kohor sjell dhe probleme të tjera (përsëritje) pasi këto dy dokumente trajtojnë çështje të njejtë (miks të tyre) frenojnë njera tjetrën dhe, përgjithësisht, mbeten prapa dinamikave të zhvillimit të mjedisit të sigurisë dhe të mbrojtjes. Psh, gjatë kësaj periudhe, ndryshimet e bëra nuk kanë ardhur si rrjedhojë e kërkesës së SU apo SSK, por janë ndërmmarrë me iniciativën e MM siç ishte dhe krijimi i “Komandës së Bashkuar” (Join command) dhe më pas u suprimua si komandë nga struktura e FA, jo si rrjedhojë llogjike e dalë nga dokumenti i SU.

Çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes në kohën e sotme po bëhen gjithnjë e më të pleksura me njera tjetrën dhe se problemet e Sigurisë nuk mund të ndahen nga ato të Mbrojtjes. Për këtë kërkesë të kohës disa shtete kanë përgatitur në një format më të gjërë një dokument të vetëm duke e titulluar: “Strategjia e Sigurisë dhe e Mbrojtjes ... të RSH”.

Në analizë të tyre, në dokumentet strategjike të SSK dhe ajo e Mbrojtjes kanë pak referenca dhe matësia zhvillimi, pak orientim financiar dhe kapacitetesh zhvillimi etj. Duhet kuptuar se ideologjia politike duket se nuk ka vend në botën postmoderne dhe të globalizuar e cila karakterizohet nga fragmentarizimi social dhe e dominuar nga konsumi personal.

Aktualisht jemi në fillim të procesit për rishikimin e këtyre dokumentave dhe, për të arritur në një dokument në shërbim të interesave të vendit, le të ndalemi tek trajtimi i nevojshëm të konceptit “Siguria njerëzore” si një element strategjik i dokumentit. Hartuesit e këtij dokumenti, për të na sjellë një dokument real, të kuptueshëm dhe të zbatueshëm duhet të fokusojnë në paragrafe ligjore konceptin « Siguria njerëzore » me të gjithë elementët zhvillues të tij, ndryshe dokumenti do të vijojë të jetë si ai paraardhësi një dokument në letër me fraza dhe fjali që nuk afrojnë zgjidhje konkrete për sigurinë e vendit.

Përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të njëzetë siguria konceptohej ekskluzivisht si siguri kombëtare dhe fokusohej në probleme që buronin prej kërcënimit, përdorimit dhe kontrollit të fuqisë ushtarake në kontekstin e konkurrencës ndërkombëtare shtetocentrike (Henk, 2005: 91-106).

Pranohet se, nxitimi drejt një bote globaliste ka sjellë mungesa thelbësore zhvillimi të shoqërisë të cilat tashmë duket se kanë sfiduar konceptin tradicional të sigurisë kombëtare duke i afuar asaj primare rolin e individit dhe jo të



shtetit, të vlerësuar si të domosdoshmen për stabilitet kombëtar, rajonal dhe global.

Kjo lëvizje konceptuale e botës u zhvillua nga një botëkuptim shumëdimensional në fushën e sigurisë njerëzore me argumentin se, siguria e “lirisë nga nevojat” dhe “lirisë nga frika” (Shkolla e “freedom from fear”. Liria nga nevojat përshin : varferia, semundjet, rreziqet natyrore. Keto faktore vrasin me shume njerëz sesa lufterat, genocidet dhe terrorizmi. e përgjithësuar për individit si mënyra më e mirë për të rregulluar ballancat e mungesës së sigurisë globale. Mosrespektimi i të drejtave të njeriut janë kërcënime për sigurinë njerëzore, ato janë tregues të mekanizmave për paralajmërim të hershëm, me qëllim të parandalimit të konflikteve.

Por, pas Luftës së Ftohtë koncepti i interesit kombëtar pësoi një transformim të dukshëm, duke u zhvendosur nga përsiatja e sigurisë shtetërore drejt përsiatjes së sigurisë (Eolfers, 1952: 482) dhe mirëqenies së individit. Prioriteti i analizës së konceptit të sigurisë gjatë kësaj periudhe u zhvendos drejt asaj që u emërtua Siguri Njerëzore (Murray, 2001: 585-610). Siguria njerëzore luan rolin e një instrumenti konceptual që përpiket t’i japë një përgjigje më të plotë në epokën bashkëkohore pyetjeve: “Çfarë do të thotë të jesh i sigurt? Etj...”

Analistët janë ndalur duke na afuar katër parime mbi konceptin e sigurisë njerëzore: Qendra e gravitetit të sigurisë – tek roli i individit; globalizim të konceptit- fenomeni rikohet; ndërveprueshmëria midis individëve; dhe zhvillimi i konceptit doktrinor “parashikimi dhe parandalimi” i fenomenit duke e lartësuar rolin individit në fokusin e politikave të sigurisë. Sigurisht koncepti globalist nuk mund të zhvillohet i ndarë veçazi nga shtetet; që siguria njerëzore të sfidoje pabarazite globale, duhet të ketë bashkëpunim mes politikës së jashtme të një shteti dhe qasjes së tij ndaj atij rajonal/ global. Të drejtat e individeve, përballë rreziqeve të mundshme nga shtetet janë bërë pjesë të strategjisë të komunitetit nderkombëtar (genocidet, të drejtat e grupeve të caktuara si grate, refugjatet).

Më praktikisht, rruga apo burimet zhvilluese për të arritur tek « Siguria njerëzore » duhet që dokumenti i SSK të

zgjidhe (me grupe pune) “skanarët” ku përshihen rreziqe të cënimit të sigurisë njerëzore. Në vlerësim të skenarit të pranuar (të gjetur) përmbajtja e dosjes duhet të plotësohet në katër drejtime: Koncepti i përdorimit; Plani i zhvillimit; Sasia e nevojshme dhe Vlera e përgjithshme.

Për të arritur plotësimin nga SSK interesin për « Siguria njerëzore » duhen pranuar dhe vlerësuar konkretisht këto fusha zhvillimi: Siguria ekonomike / Siguria e Ushqimit / Shendetesore / Mjedisore / Personale / Komuniteteve / dhe Siguria politike.

Problemi i sigurisë ekonomike është më kritik, problematika e të cilit përshin dhe shtetet e zhvilluara. Kjo strategji duhet të mirë përcaktojë nivelin e minimumit jetik, pagën bazë për të mbijetuar individët duke afuar strategji për papunësinë si një faktor destabilizues që krijojnë terrorizmin, tensione politike, rrisin frymën nacionaliste dhe atë etnike. Vlerësimet për nivelin e varfërisë të vendit dhe në rajon si burim për rritjen e autoritetit të “pushtetit të individit” të konsideruar si element (i ri) destabilizues i sigurisë, burim i terrorizmit kombëtar, rajonal e global.

Informacion i përgjithshëm: RSH për sigurinë njerëzore

Para viteve '90-të: Parimi i politikës të periudhës para viteve '90-të ishte “njeriu kapital i çmuar”. Të vlerësuar si nocion zhvillimi, në dukje përmbante një filozofi vlerësimi duke rritur rolin e shtetit, i cili ishte garant i sigurisë individuale, ekonomike dhe sociale, por sistemi i hoqi sigurinë politike. Pas viteve '90-të: Vitet pas '90-të, apo periudha e tranzicionit solli një zhvlerësim të konceptit të sigurisë shtetërore (amulli) duke afuar për RSH një vakuum sigurie me pasojë kërcënuese ndaj sigurisë ekonomike, sociale që u faturuan në atë individuale, të cilët morrën masivisht rrugën emigracionit legal dhe ilegal. Realisht në vendin tonë u vendos pluralizmi politik dhe u fituan të drejtat dhe liritë e individit. Parimi i sigurisë politike u normëzua. Gjatë periudhës “92-97”, qartazi, sigurisë politike i mungonin treguesit cilësorë, si përvoja e pamjaftueshme e sigurisë politike dhe pjekuria demokratike, e cila ndikoi tek treguesit e tjerë të sigurisë. Vendi u përfshi në kriza të njëpasnjëshme

ku efektet negative vazhdojnë edhe sot. U duk se, periudha e tranzicionit bëri të rivlerësohet mënyra e përballimit të kërcënimeve të ndryshme ndaj sigurisë politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Në një pamje tjetër, u transformua drejtimi nga i “centralizuar shtetëror” i sigurisë në një drejtim të quajtur “individ- njerëzor”. Në se do të analizojmë periudhën pas krizës së vitit 1997, të vlerësuar si kriza më e rëndë në fushën e sigurisë që ka kaluar vendi ynë, u duk si lëvizje për të përgatitur një dokument strategjik për t’i shërbyer interesave të sigurisë në vend. Në një vlerësim të përgjithshëm të dokumenteve strategjike post 97-të, në analizën time, ato janë formuluar me fraza si një detyrim rutinë dhe se ato nuk kanë qënë në gjendje të formulojnë qartë doktrinën për sigurinë njerëzore si element bazë që drejton politikën në fushën e sigurisë kombëtare. Në këtë mënyrë ende mungon një ndërlidhje e qartë mes aktorëve që ofrojnë siguri (aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë) dhe konsumatorëve të sigurisë – veçanërisht lidhur me aspekte si siguria ekonomike, siguria mjedisore, siguria shëndetësore, etj. të cilat përballen me rreziqe të shtuara. Për të kuptuar mosfunksionimin e Strategjisë kombëtare, le të ndalemi tek siguria mjedisore e cila gjatë tranzicionit nga strukturat e dobëta shtetërore humbi kontrollin mbi territorin si një nga elementët bazë të dokumentit duke sjellë dem të madh në sigurinë mjedisore (Shembull: gjatë dhe pas viteve '90-të u ngritën 300 mijë ndërtime pa leje, u prenë rreth 40% e pyjeve si dhe u zunë me ndërtime rreth 30% e tokës bujqësore në ultësirën perëndimore).

Duhet të kuptojmë efektin “domino” të elementëve përbërës të sigurisë njerëzore për të vlerësuar “zinxhirin e pasojave” ku termat afatgjatë të trazicionit kaluan në zgjidhje afatshkurtë, duke shkatërruar gjithçka të ndërtaur, lëvizja demografike pa një plan sistemimi, ndërtime pa leje, shkatërrime masive të pyjeve, të cilat dhanë efekte të menjëhershme dhe kërcënuan sigurinë ekonomike e sociale të individit, nëpërmjet nevojës emergjente për të mbijetuar, një strehë e punë të përkohshme duke e kthyer shtetin “një fis”. RSH është një shembull i keq dhe unik në botë përse i përket masivizimit të emigracionit (1/2 e popullsisë) të pasviteve 90-të të detyruar nga varfëria; por përgjatë 23 viteve nuk është parë dhe sigurisht nuk egziston mundësia e riatdhesimit të tyre, ata janë pjesa aktive e Sigurisë Kombëtare. Shtetformuesit tanë duhet të kuptojnë mirë se nga mosnjohje të termit “siguria njerëzore” në Shqipëri për gjatë më shumë se 20 vite është kaluar në ekstremitetin më të paskrupull mes zgjidhjeve të llojit “siguria për individin nga vet individi”, që kupton përjashtimin e zgjidhjes të sigurisë nga shteti. Edhe pse siguria njerëzore të afron, apo duket, një kalim nga tradicionalja e sigurisë shtetërore në atë individuale, që kupton, në qendër të sigurisë pranohet individi, nuk presupozon se po eliminohet roli i shtetit si garantues i sigurisë, por përkundrazi kemi të bëjmë me politika bashkëvepruese të ndërvarura (plotësim të standardeve për 7 fushat e sigurisë) nga sjelljet e individit në fushën e vlerësimit për të përballur rreziqet që vijnë nga mosarritja e fushave

të sigurisë njerëzore. Me fjalë të tjera kërkohet apo kemi të bëjmë me detyrimin për zgjidhjen e “sistemit zinxhir të ndërvarësive së sigurisë njerëzore” jo vetëm nga roli që ato ushtrojnë tek njera-tjetra por edhe nga loja e aktorëve të brendshëm/ jashtëm shtetërorë/ jo shtetërorë që ndikojnë në sigurinë për të parashikuar dhe përballuar rreziqet. Duhet të kuptojmë se politikën publike në fushën e planifikimit strategjik, janë thelbësore për të arritur në një qartësi zhvillimi për sigurinë njerëzore. në përputhje me prioritetet e zhvillimit dhe objektivin politik për të qënë vend anëtar i Bashkimit Europian. Le të vlerësojmë RSH si vend anëtar i NATO-s, e cila ndjek me vëmendje zhvillimet e politikës së jashtme të sigurisë dhe se ajo tashmë është prezantuar dhe ka dhënë imazhin si eksportuese e sigurisë jashtë vendit, përmes pjesëmarrjes në misione paqeruajtëse të kudozhvilluar jashtë vendit por nuk ka ndërtaur ende një strategji zhvillimi për të plotësuar nevojat e saj të shumta të sigurisë brenda vendit.

RSH më shumë duhet të prodhojë siguri brenda vendit që aktualisht ndeshet me sfida të panumrta të cilat kërkojnë për të prodhuar një strategji panifikuese për të financuar ringritjen e institucioneve dhe efektivitetin e tyre në lartësinë “siguri-prodhuese”. Për sa më lart, vlerëso (apo dëshiroj) se, dalja e këtij dokumenti të jetë:

Më praktik, më bashkëpunues, më i kuptueshme duke rritur cilësinë e përgatitjes gjithpërfshirëse të tij; me synim: identifikim, analizë dhe mbajtje përgjegjësie nga aktorët përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes; në të kundërtën: pa bartës, pa orientim kapacitetesh dhe pa kufi fondesh të mirëpërcaktuara, Strategjia Kombëtare kthehet në një leksion moralizues.

Analistët dhe specialistët e fushave të ndryshme do t’u duhet të analizojnë dhe të japin zgjidhje disa elementëve (çështjeve) që konsiderohen “dosje të nxehta”, qofshin këto në planin e jashtëm dhe të brendshëm, të cilat influencojnë direkt mbi sigurinë e RSH.

Pra, kërkohet një dokument i vetëm kombëtar, i mbështetur me plane rishikimesh konkretë nga ministratë që i detyrohen dokumentit të SSK (psh MM): i shtrirë në kohë, afat mesëm/gjatë, me vlerësim të Kostos financiare dhe afatit e përgatitjes për të arritur, me aftësitë operacionale në interes të misionit strategjik të RSH. Kjo strategji nuk duhet të jetë më një dokument për sirtar por një program pune për të zhvilluar sigurinë kombëtare në format ndryshe- për “sigurinë njerëzore”.

Përgatitja e dokumentit (Modeli Francez) : Me dekret të Presidentit të Republikës, bazuar në raportin e Kryetarit të Keshillit të Ministrave, shtator 2012 krijohet grupi i punës me personalitete të lartë të shtetit dhe të jetës franceze. « Libri i Bardhë 2013 » u përgatit, përveç angazhimit gjithpërfshirës të komisionit pluralist, me personalitete të të gjitha disiplinave dhe horizonteve profesionale dhe ato politike (sindikalistë e filozofë, shoqëria civile), janë përfshirë dhe partnerët evropiane si, Ambasadori Britanik në Francë, Kryetari i Konferencës të Sigurimit të Mynihut, Shefi Ekzekutiv i Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes e të etj. Gjatë periudhës përgatitore pothuajse një vjeçare, puna e bërë prezantohet në publik (debate televizive) dhe në sitin e internetit për diskutim.

Intesfikohen operacionet e transportit të municioneve në uzinat ushtarake

Për muajin shkurt janë kryer mbi 500 operacione nga grup-depot e Macukullit, Qafë Mollës, Nojës, Mirakës drejt uzinave të Policanit, Mjekësit dhe Gramshit, janë kryer mbi 75 mijë kilometra udhëtime nga mjetet e Batalionit të Transportit dhe janë realizuar të gjitha detyrat e përcaktuara në planin e operacioneve të përcaktuara në planin e operacioneve.

Puna dhe vëmendja kryesore për muajin shkurt 2014 në Batalionin e Transportit është përqendruar në transportin e municioneve nga Grup Depot në Uzinat Ushtarake për tu bërë asgjësimi i tyre në rrugë industriale. Në muajin shkurt janë bërë mbi 75 mijë kilometra udhëtime nga mjetet e transportit të këtij Batalioni në zbatim të planit të operacioneve duke çuar çdo ditë sasi të konsiderueshme municioni në Uzinat e Policanit të Gramshit dhe të Mjekësit. Rreth 75 mjete të këtij Batalioni kanë punuar pa ndërprerje gjatë 24 orëve të ditës nga grup depot e Qafë Mollës në drejtim të Uzinës së Mjekësit duke zbatuar më së miri rregullat e sigurimit teknik por dhe duke arritur gjithmonë në kohë në destinacion. Po ashtu një sasi mjetesh ka kryer udhëtime nga grup depot e Nojit drejt uzinave të Policanit dhe të Mjekësit. Përgjegjshmëria për detyrën ka qenë gjithmonë në lartësinë e detyrës. Motua e punës ka qenë ndihma për njëri tjetrin dhe mbajtja e një ndërlidhjeje të pandërprerë për të ruajtur gjithmonë të konsoliduara rejset. Punën më të vështirë e kanë patur efektivat që kanë transportuar municione nga grup depot e Macukullit në drejtim të uzinës së Policanit, e cila është një distancë shumë e madhe dhe në rrugë shumë të vështirë malore të pashtuara dhe me kthesa të forta. Puna ka vazhduar intensivisht dhe duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik. Efektivat që kanë punuar në Mirakë kanë transportuar sasi të



municionit sipas planizimit ashtu si dhe efektivat që kanë punuar nga grup depot e Shmilit dhe Borizanit drejt Uzinave ushtarake. Po ta shikosh tërë këto operacione thotë zëvendëskomandanti i Batalionit kapiten Egert Kuka bindesh se volume i punës është shumë i madh ditët janë shumë intensive dhe përgjegjësitë janë shumë të mëdha. Por parapërgatitja e efektivit dhe mbi të gjitha detyrat konkrete dhe të sakta kanë çuar në realizimin e detyrave. Ndërsa për dy fundjava Batalioni është angazhuar dhe për pastrimin e territorit në bazë të urdhrave ku janë angazhuar në drejtim të Shkodrës 25 trupa personeli, përfshirë 6 automjete për transportin e

mjeteve të rënda, fadroma dhe 2 automjete për pastrimin e sipërfaqes së caktuar për repartin tone. Gjithsej gjatë këtij aktiviteti janë realizuar 1720 km. Në drejtimin e Vorës drejt Tiranës janë angazhuar 25 trupa personeli dhe 7 automjete për transportin e mjeteve të rënda (3) dhe pastrimin e territorit të përcaktuar (4), ku janë përkthuar 1120 km. Për periudhën në vijimësi puna do të vazhdojë për transportimin e municioneve nga grup depot nëpër uzinat ushtarake dhe transporti i materialeve logjistike si dhe transporte të tjera sipas urdhrave dhe fonogramave të ardhur nga Brigada Logjistike. Për realizimin e këtij volumi pune, padyshim një rol të rënd-

sishëm luan i gjithë stafi me të cilin unë punoj, thotë zëvendëskomandanti Eugert Kuka ku dhe po përmend disa nga emrat të cilët gjatë këtij muaji kanë qenë në udhëtim në grup depot nëpër male dhe kanë kryer me përpikmëri detyrën. Kapiteni Kuka thotë se ka spikatur puna në grupe kapitenit Klodian Lico shef i seksionit të operacioneve, kapiten Daniel Harka specialist i operacioneve, toger Serafini Osman specialist i shfrytëzimit dhe i tërë manovratorëve dhe magazinierëve. Shefat e Seksioneve dhe komandantët e Kompanive nuk janë vetëm drejtuesit e nënreparteve përkatës të batalionit të transportit, por edhe bashkëpunëtorët e ngushtë të komandantit dhe shefit të Shtabit të batalionit të transportit. Puna në grup si një ekip i vetëm dhe harmonia që ekziston ndërmjet seksioneve dhe kompanive bën të mundur realizimin me sukses të të gjitha urdhrave dhe detyrave të ardhura nga Brigada Logjistike. Një rëndësi të madhe në këto operacione shumë të komplikuar ka dhe puna e mekanikëve mirëmbajtësve dhe teknikëve të automjeteve, të cilat i janë përgjigjur detyrave të gatishmërisë teknike. Ndihma dhe puna e komandës së Brigadës ka qenë parësore. Gjeneral-brigade Syrja Gjoka, komandant i kësaj Brigade e shikon me prioritet punën e transportit të municioneve dhe shefi i operacioneve çdo ditë mban evidencën shumë të qarta, të rregullta dhe kontakte për çdo orë të ditës me efektivat që transportojnë municion.

Bashkim Male

Zhvillohet në KDS aktiviteti sportiv "Dita e Vrapimit të CISM-it 2014"

Në kuadër të festimeve të 66-Vjetorit të formimit të Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake (CISM), në mjediset e ambientet stërvitore të KDS në datën 18 shkurt 2014, u zhvillua aktiviteti sportiv "Dita e Vrapimit të CISM-it 2014". Programi i përbashkët i aktiviteteve sportive për të gjitha institucionet e KDS-së, ku morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës nga AFA, ANO, SHT Bunavi, përmbante aktivitete të ndryshme sportive, futboll, volejball, basketboll midis ekipeve pjesëmarrëse. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë zv/komandanti i KDS kolonel Ruzhdi Kuçi, Drejtuesit e institucioneve të varësisë së KDS, si dhe personeli përgjegjës për aktivitetin. Në fjalën e rastit, Kolonel Kuçi, ndër të tjerash foli për historikun e CISM-it dhe pjesëmarrjen e FA-së e KDS në aktivitetet ndërkombëtare. Aktivitetet vijuan në ambientet e palestres, ku u zhvilluan ndeshje volejballi, basketbolli midis institucioneve, sikundër dhe ndeshje futbollit midis ekipit të AFA-së dhe ANO-së. Aktiviteti i CISM në rang KDS, u përfundoi me krosin masiv 5 km me të gjithë pjesëmarrësit. Në përfundim të garës u arritën këto rezultate: Ekipi i ANO zuri vendin e I-rë duke fituar edhe kupën në këtë disiplinë. Si individë u dalluan; rreshter Ediol Sollaku Kursant në ANO në vend të parë, rreshter Besmir Hoxha Kursant në ANO në vend të dytë, kolonel Agim Kuçana në AFA në vend të tretë. Në aktivitetet e tjera sportive, ekipi i AFA zuri vendin e parë në futboll dhe basketboll, kurse ekipi i ANO zuri vendin e parë në volejball. Ky aktivitet shërbeu për përzgjedhjen e elementëve që do të përfaqësojnë Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Forcat e Armatosura në garat e ndryshme që do të zhvillohen në të ardhmen në kuadër të kampionateve e aktiviteteve të CISM-it.

Nënkolonele Alda Sula

Zhvillohet "Dita e Vrapimit të CISM-it 2014", në Forcat Tokësore

Me 18 Shkurt 1948, francezi Henri Debrus, së bashku me kolegët e tij ushtarakë nga Franca, Belgjika, Holanda, Luksemburgu dhe Danimarka krijuan në Nise të Francës, Këshillin Kombëtar të Sporteve Ushtarake (CISM) me synim promovimin e Paqes nëpërmjet sportit, ndërmjet efektiveve të Forcave të Armatosura në të gjithë botën. Me qëllim promovimin e tij në vitin 2006 u vendos që 18 Shkurti të jetë "Dita e Vrapimit të CISM-it" në të gjithë botën. Kjo ditë, si ngjarja më e rëndësishme e CISM-it, përcjell mesazhin e solidaritetit dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një traditë e familjes së madhe të CISM-it dhe strukturave të Forcave të Armatosura. Nëpërmjet aktiviteteve të CISM-it, është bërë e mundur që ushtarakët të cilët më parë mund të jenë takuar në fushëbetje, të takohen në fushën e sportit nën moton "Miqësi nëpërmjet sportit". Për të përkujtuar 66-vjetorin e formimit të Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake (CISM-it), më datë 18.02.2014, në vend-dislokimin e repartëve të Forcave Tokësore, si në garnizonin "Zall Herr", qendër, Garnizonin "Vau Dejës" Shkodër, Garnizonin "Poshnje" Berat, Batalionin Komando dhe Batalioni i Forcave Speciale u zhvillua aktiviteti sportiv "Dita e Vrapimit të CISM-it 2014". Gjatë kësaj dite u organizuan aktivitete të ndryshme sportive si : kros sportiv 8 km, ndeshje mini futboll, volejball, basketboll, alpinizëm, ping-pong etj. Duke e vlerësuar zhvillimin e aktivitetit sportiv, "Dita e Vrapimit të CISM-it 2014", si një event të rëndësishëm, ndryshe nga vitet e tjera, ku ekipet në rang FA grumbulloheshin në Komandën e Forcave Tokësore, këtë vit, ky aktivitet në FT u organizua në bazë garnizonesh dhe repartesh. Në krye të organizimit të këtyre aktiviteteve qëndronin komandantët e



repartëve. Në Garnizonin qendër "Zall-Herr", ku është dislokuar Batalioni i Dytë i Këmbësorisë, në ceremoninë e hapjes së këtij aktiviteti merrnin pjesë kolonel Dilver Hoxha, zv.komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Adi Ndoni, shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Ardian Bali, komandant i b2k, nënkolonel Ilir Bytyçi, përfaqësues nga Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, z.Ramazan Zelia, përfaqësues nga Drejtoria e Sporteve në QKMBM, Ministria e Mbrojtjes, si dhe pjesëtar nga shtabi i Forcave Tokësore. Të pranishmit i përshëndeti zv.komandanti i Forcave Tokësore, kolonel Dilaver Hoxha, i cili në fjalën e tij, pasi ju uroj sukses në gara efektiveve, u shpreh se në këtë organizëm të madh shumë disiplinor të Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake (CISM-it) aderohet Forcat e Armatosura të 133 shteteve anëtare, përfshi këtu edhe Shqipërinë, e cila ka është anëtare që nga viti 1995. "Në të gjithë botën, theksoi kolonel Hoxha, sporti është bërë pjesë integrale e shoqërisë. Ai është një mjet i pazëvendësueshëm i zhvillimit të qëndrueshëm, i promovimit të paqes, kulturës dhe edukimit, duke ju dhënë veçanërisht të rinjve mundësi të reja dhe shpresë, ku miliona njerëz nëpër botë praktikojnë sportin për të

bërë një jetë sa më të shëndetshme, larg stresit dhe ve-seve të këqija...". Ai përmendi një sërë aktiviteteve që kanë lënë gjurmë në shkallë ndërkombëtare si; Forcat e Armatosura Shqiptare, që nga viti 2008, kanë zhvilluar çdo vit këtë aktivitet, duke ju bashkuar familjes së madhe të CISM-it, si ekipi i Atletikës së Forcave të Armatosura në vitin 2012, i cili arriti të ngjitet dy herë në podium në Kampionatet Rajonale të Vrapimit Malor, duke zënë vendin e tretë në Serbi dhe vendin e dytë në Kroaci, një tjetër arritje ishte renditja në vendin e parë i Forcave tona Speciale në stërvitjen me Forcat Speciale të vendeve të Ballkanit, zhvilluar në Maqedoni, gjatë vitit 2012 etj. Edhe gjatë vitit 2014, theksoi Koloneli, Forcat Tokësore kanë planifikuar aktivitetet të ndryshme sportive në rang FA force dhe repartesh, ku nënvizoi faktin se në repartet tona ekziston infrastruktura e nevojshme si palestera, kënde sportive, kalçeto mini-futbollit, etj, pra kemi të gjitha mundësitë dhe resurset që të zhvillojmë aktivitetet me nivel, ndaj çdo komandë duhet ti shfrytëzojë ato. Për të bërë të mundur këtë, të gjithë komandantët, specialistët e përgatitjes fizike, trajnerët, teknikët, shpeshherë edhe me vullnetarizëm siç ndodh edhe në lëvizjen e madhe "Olimpike",

duhet ti përkushtojnë kohën mbështetjes së sportit dhe atletëve për ta bërë sportin një realitet në jetën tonë të përditshme. Forcat Tokësore kanë ambientet me të gjelbërta me ajër të pastër, larg zhurmës dhe ndotjes, në të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin sportiv çdo ditë, si pjesë të rëndësishme të para stërvitjes në interes të mirë të formimit të tyre fizik e psikologjik. Në mbyllje të fjalës së tij kolonel Hoxha, theksoi se, nuk mund të kemi përfaqësim dinjitoz në rang FA, kombëtar apo ndërkombëtar pa patur kampionate dhe aktivitete në nivel nënrepartit, repartit, force e FA, pa patur ekipe permanente në sportet prioritare dhe pa sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme dhe të nevojshme të sportistëve cilësor". Më pas nisën garat sportive fillimisht me krosin sportiv 8 km dhe vijimin me aktiviteteve si mini-futboll, basketboll, alpinizëm, volejball, shah, pimpong etj. Nga prononcimet e komandantëve të repartëve kolonel Ardian Bali, b2k, nënkolonel Nikolin Lazri, blk, nënkolonel Gëzim Marku, b3k, nënkolonel Arben Hoxha, batalioni komando dhe nënkolonel Qazim Hoxha, batalioni i forcave speciale, mësojmë se kjo ditë është vlerësuar nga të gjithë efektivat e repartit dhe nënrepartëve, për të cilën janë marrë masa të mira organizative dhe krijimin e një dekori sa më festiv. Sipas tyre në të gjitha llojet e sporteve ka mbizotëruar shpirti i garës dhe motivimi për të zënë vend nderi. Në të gjithë disiplinat, shprehen ata, janë evidentuar ekipe dhe individë më të spikatur. Komandantët në mbyllje të aktivitetit, vlerësuan performancën e mirë të ekipeve dhe individëve, rezultat të cilin e shikojnë si fryt të punës së komandantëve të nënrepartëve dhe drejtuesve të këtyre ekipeve. Ata shprehen se, në inkurajimin e individëve në lloje të ndryshme të sportit, mbështetja dhe motivimi bëjnë të mundur arritjen e standardeve të mira. Aktiviteti u përshkrua nga atmosferë festive.

Major Nexhbedin Basha

Vizioni i presidentit Obama për arsimin, ekonominë, politikat sociale dhe FA

“State of the union”, fjalimi i përvitshëm i fillim-vitit të presidentit të SHBA-së

Nga: Agron Loci

(vijon nga numri i kaluar)

Duke i bërë thirrje të gjithë politik-bërësve të jenë të vendosur të miratojnë me konsensus reformën në fushën e emigracionit presidenti deklaroi se, nëse kjo reformë do të implementohej atëherë kjo do të rriste ekonominë amerikane si dhe do të ulte deficitin në dy dekadat e fundit me rreth 1 trilion dollarë. Në fjalën e tij nuk mund të mbetej jashtë vëmendjes edhe rëndësia e reformës së sistemit arsimor. Ajo është iniciuar disa vite më parë dhe rrok të gjitha elementët e shkollimit duke filluar nga profilizimi i shkollës, krijimi dhe konsolidimi i kurrikulave shkollorë mbështetur tek nevojat e tregut dhe ekonomisë amerikane por edhe nevojat globale, përmirësimi i kushteve të studimit por edhe i nivelit të bursave për nxënës e studentë e deri tek kualifikimi i mësimdhënësve, marrëdhëniet ndërmjet prindërve mësuesve dhe stafit drejtues, rritja e nivelit të kërkimit shkencor dhe domosdoshmëria e mbështetjes së tij nga ana e shtetit dhe biznesit. Me rëndësi konsiderohet gjithashtu bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe biznesit në mënyrë që profilizimi i kurrikulave dhe shkollës të rezultojë eficient pas përfundimit të saj nga ana e nxënësve dhe studentëve. Nevoja urgjente për reformimin e sistemit të pensioneve, reformimin e sistemit të përkujdesjes shëndetësore, përcaktimi me ligj i pagës minimale për orë, ofrimi i mundësive dhe shanseve të barabarta për gratë si shtresë shoqërore e cila pavarësisht kontributit të saj në realizimin e të mirave materiale por edhe në edukimin e brezit të ri vazhdon të mos paguhet për të njëjtën punë me të njëjtën pagë si meshkujt ishin disa çështje të tjera të ngritura nga ana e presidentit dhe që për të ai kërkoi mbështetjen nga ana e të gjithë aktorëve qofshin këta politikanë, sipërmarrës, legjislatorë etj. Domosdoshmëria e mbështetjes dhe mbajtjes gjallë të frymës së kurajës civile për të thënë dhe mbrojtur fjalën dhe mendimin për çështje të ndryshme ka qenë dhe mbetet shpirti dhe mekanizmi që e ka shtyrë gjithnjë përpara kombin amerikan prandaj presidenti bëri thirrje që e drejta për të thënë pa frikë fjalën, për të votuar dhe për t'u organizuar duhen mbështetur pasi janë një detyrim i gjithsecilit që është i bindur dhe mbështet përparimin e vendit. Në këtë kontekst ai kërkoi ndërmarrjen e një reforme elektorale e cila nga njëra anë të jetë fleksibël duke u garantuar shtetasve amerikanë lehtësira kohore në proceset zgjedhore dhe nga ana tjetër të sigurojë që gjithkush ta ndjejë dhe të besojë se zëri i tij përmes votës është dëgjuar.

* * *

Në fjalimin e tij nuk kishte sesi të mungonte edhe qëndrimi dhe vizioni i tij për perspektivën e angazhimeve të forcave të armatosura dhe të diploma-



cisë amerikane. Është interesant fakti se për herë të parë kemi një qasje të tillë ku dy sfera në dukje larg njëra tjetrës siç janë forcat e armatosura dhe diplomacia analizohen në të njëjtën pjesë të fjalimit. Diplomacia dhe forcat e armatosura, njëra me forcën e fjalës dhe të argumentit, tjetra me forcën e armëve dhe të vendosmërisë për të vendosur rendin dhe paqen shkojnë krah për krah në fjalimin e tij. Në fakt për shumë njerëz që janë larg këtyre fushave ato ngjasojnë me dy realitete që janë larg njëra-tjetrës dhe që nuk kanë lidhje mes tyre por në thelbin e tyre ato synojnë të arrijnë të njëjtin qëllim pavarësisht mjeteve dhe instrumenteve që përdorin për arritjen e tij. Presidenti bëri një analizë të realitetit të angazhimit të trupave amerikanë jashtë vendit dhe duke vlerësuar rolin e tyre në garantimin e sigurisë dhe paqes jo vetëm në vendet ku janë me mision por edhe për SHBA, ai shpreh vendosmërinë për tërheqjen e trupave nga misioni i ISAF deri në fund të këtij viti. Pas 2014 trupat amerikane do të operojnë tërësisht si forca ushtarake që mbështesin autoritetet zyrtare ushtarake dhe policore afgane detyrë kjo që do të realizohet në bashkëpunim me aleatët. Ka ardhur koha që autoritetet afgane të marrin përgjegjësitë për drejtimin e vendit të tyre. Ai shprehu vendosmërinë që nëse qeveria afgane do të firmosë një marrëveshje sigurie për të cilën prej kohësh po negociohet me të, atëherë në Afganistan do të qëndrojë një numër i vogël trupash amerikanë të cilët së bashku me trupat e disa vendeve aleate të NATO-s do të realizojnë dy misione kryesore : trajnimin dhe asistencën e forcave afgane si dhe mbështetjen e operacioneve antiterrorizëm ndaj çdo fraksioni të Al-Kaedës. Me gjithë entuziazmin e shprehur për suksesin e angazhimit të trupave amerikane në misionin e Afganistanit përsëri presidenti shprehet se rreziku i terrorizmit vazhdon të jetë ekzistent. Nëse drejtimi i Al-Kaedës është goditur dhe vazhdon të goditet kjo organizatë ka arritur që të shtrijë aktivitetin e saj në vende të tjera të botës jashtë Afganistanit. Jemeni,

Somalia, Iraku dhe Mali janë disa vende ku rrjeti i kësaj organizate ka shtrirë rrënjët e tij dhe ku SHBA në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët janë të angazhuar në luftën kundër tyre. Në fjalën e tij presidenti përmend edhe situatën në Siri duke theksuar vendosmërinë e SHBA për të mbështetur opozitën siriane e cila është kundër terrorizmit dhe grupeve terroriste. Duke ju referuar angazhimeve në luftën kundër terrorizmit në SHBA ai e vë theksin në disa aspekte duke përmendur forcimin e sistemeve të mbrojtjes, marrjen e masave ndaj kërcënimeve të reja siç janë sulmet kibernetike. Ndërkohë që reforma dhe rishikimi i buxhetit të mbrojtjes duhet që të fokusohet në investimin në kapacitete për të cilat trupat amerikane kanë nevojë për të vazhduar e përmbushur me sukses misionet e tyre në të ardhmen. Për presidentin është e qartë se siguria e SHBA dhe e shtetasve amerikanë nuk mund dhe nuk duhet të varen vetëm nga angazhimi i trupave amerikane në misionet jashtë vendit. Si Komandant i Përgjithshëm i FA ai shprehu vendosmërinë për të mos dërguar në misione trupat amerikane, ku rreziku dhe pasiguria për to është e lartë dhe ku pjesëmarrja e tyre nuk është domosdoshmërisht e nevojshme. Në këtë kontekst presidenti mendon dhe kërkoi mbështetjen e Kongresit duke argumentuar se këto angazhime ushtarake do të ishin më efikase dhe më me pak kosto për taksapaguesit amerikanë nëse do të bëhej një reformim i sistemit të programeve të inteligjencës në përpjekjet dhe luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar. Nevoja e reformimit të këtij sistemi sipas presidentit mbështet interesat e shtetasve amerikanë dhe nuk prek si dhe nuk do të prekë sferën private të askujt. Në kushtet e një realiteti ku kërcënimet janë komplekse ashtu siç është kompleks dhe i ndërvarur i tërë realiteti global siguria varet nga një sërë faktorësh të cilët duhen njohur dhe marrë në konsideratë me shumë kujdes. Për presidentin një rol shumë të rëndësishëm në këtë kontekst në përbaljen me sukses të kërcënimeve dhe të pasigurisë ka luajtur dhe vazhdon

”

Është me shumë rëndësi për lidhshmërinë politike dhe ushtarake të FA të Shqipërisë që duke i konsideruar SHBA si aleatin tonë më të rëndësishëm strategjik të orientojmë drejt dhe me vizion politikat e zhvillimit të FA si dhe buxhetin e mbrojtjes në mënyrë që ato t'i shërbejnë të ardhmes. Çdo vonesë në kuptimin e mesazheve që vijnë nga SHBA dhe aleatët tanë do të përkthehet si mungesë profesionalizmi për të kuptuar trendin e zhvillimeve

të luajë diplomacia amerikane. Falë punës së tyre diplomatëve amerikanë ja kanë dalë të parandalojnë rënien në duart e grupeve terroriste të materialeve nukleare, falë angazhimit të tyre regjimi sirian i dorëzoi komunitetit ndërkombëtar armët kimike dhe se SHBA janë të vendosura të mbështesin aspiratat e popullit sirian për një të ardhme të cilën ata e meritojnë, një të ardhme pa diktaturë, pa frikë dhe pa terror. Diplomatatë amerikanë janë gjithashtu të vendosur të mbështesin përpjekjet e izraelitëve dhe palestinezëve për të gjetur gjuhën e përbashkët në arritjen e paqes aq shumë të kërkuar përmes krijimit të një shteti dinjitoz dhe të pavarur palestinez i cili nuk duhet të përbëjë kërcënim për stabilitetin e rajonit dhe të bjerë ndesh me interesat e popullit izraelit. Falë angazhimit dhe vendosmërisë së diplomacisë amerikane është arritur që Irani të ndalojë programin nuklear madje të kthejë prapa pjesë të këtij programi. Së bashku me aleatët SHBA janë në vëzhgim dhe po inspektojmë ecurinë e përbashkës së kushteve të negociuar me qeverinë e Iranit për ndalimin e procesit të prodhimit të bombës atomike. Politika amerikane është e ndërgjegjshme se këto bisedime me drejtuesit politikë të Iranit do të jenë të vështira sa kohë që Irani është shprehur hapur në mbështetje të grupeve terroriste si Hezbollah të cilat janë kërcënim për sigurinë e rajonit dhe të interesave amerikane dhe të aleatëve të tjerë. Duke njohur situatën për presidentin është e qartë se këto bisedime nuk do të mbështeten tek besimi por tek inspektimet e bëra nga ekspertët amerikanë dhe ndërkombëtarë të cilët do të japin informacion nëse Irani nuk po ndërton bombën atomike. Presidenti është i vendosur për të mbështetur diplomacinë amerikane në këtë angazhim serioz pasi sipas tij kështu mund të garantohet siguria kombëtare amerikane madje ai është i vendosur se nëse konstatohen mos përmbushje të detyrimeve nga ana e Iranit atëherë ai si president është për thellimin e sanksioneve ndaj tij. Nëse drejtuesit iranianë do të përmbushin dety-

rimet atëherë SHBA do të mbështesin përpjekjet e tyre për t'iu ribashkuar komunitetit ndërkombëtar dhe në të njëjtën kohë do të evitohej një konflikt me pasoja të rrezikshme për rajonin por edhe më gjerë. Duke ju referuar aleancave presidenti thekson se aleanca e SHBA me vendet evropiane është më e forta që ka njohur njerëzimi në historinë e tij dhe se SHBA vazhdojnë të mbështesin këtë aleancë dhe ta konsiderojnë atë si shumë të rëndësishme për paqen dhe sigurinë kudo në botë. Në të njëjtën kohë SHBA mbështesin çdo përpjekje për demokraci nga vende që ndodhen në kontinentin afrikan, në Evropë por edhe në Amerikën Jugore. Në lidhje me zhvillimet në Ukrainë SHBA mbështesin të drejtën e shtetasve të këtij vendi për të shprehur në mënyrë të hapur dhe paqësore mendimet si dhe të drejtën legjitime për të vendosur për të ardhmen e vendit të tyre. Një fokus i veçantë i politikës së jashtme amerikane do të vazhdojë të mbetet zona e Azisë dhe Pacifikut ku mbështetjen përpjekjet për një nivel më të lartë sigurie dhe prosperiteti. Orientimi në këto linja garanton rritjen e nivelit të paqes dhe të sigurisë në një afat të gjatë kohor. Nuk ka sesi në arritjen e këtij objektivit të mos ndikojnë edhe përpjekjet për më tepër demokraci dhe të drejta të individit në shumë vende të botës prandaj SHBA janë dhe do të jenë në krah të të gjithë atyre popujve që luftojnë për të siguruar dhe fituar me ligj të drejtat e tyre. Si konkluzion mund të thuhet se i tërë fjalimi i presidentit Obama ka në themelin e tij mbrojtjen, konsolidimin dhe thellimin e vlerave që qëndrojnë në bazamentin e shoqërisë dhe të SHBA. Por që këto të jenë të garantuara duhet që ato të mos rrezikohen nga faktorë dhe kërcënime të natyrave të ndryshme. Për këtë arsye presidenti bëri një analizë gjithëpërfshirëse dhe arrin të argumentojë lidhjen e pamohueshme të të gjithë faktorëve qofshin këta të natyrës ekonomike, politike, kulturore, të mbrojtjes apo të sigurisë me qëllimin final garantimin e sigurisë për shtetasit amerikanë. Në fjalën e tij ka një lidhje organike ndërmjet rëndësisë që ka faktori i brendshëm në bashkëpunim me faktorët e jashtëm për të garantuar ecurinë, prosperitetin dhe sigurinë. Ndërkohë që në fjalën e tij në lidhje me forcat e armatosura ai përcaktoi qartë linjat kryesore ku do të fokusohet puna dhe investimi në të ardhmen. Në këtë kontekst është me shumë rëndësi për lidhshmërinë politike dhe ushtarake të FA të Shqipërisë që duke i konsideruar SHBA si aleatin tonë më të rëndësishëm strategjik të orientojmë drejt dhe me vizion politikat e zhvillimit të FA si dhe buxhetin e mbrojtjes në mënyrë që ato t'i shërbejnë të ardhmes. Çdo vonesë në kuptimin e mesazheve që vijnë nga SHBA dhe aleatët tanë do të përkthehet si mungesë profesionalizmi për të kuptuar trendin e zhvillimeve si dhe mund të shoqërohet me kosto të panevojshme dhe të pajustifikuara buxhetore.

Rasmussen thekson rëndësinë e sigurisë detare gjatë vizitës në Komandën Detare të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, së bashku me kryetarin e Komitetit Ushtarak dhe ambasadorë nga Këshilli i Atlantikut të Veriut diskutuan rreth operacioneve detare dhe të ardhmen e sigurisë detare gjatë një vizite në selinë detare të NATO-s në bazën Northwood në Mbretërinë e Bashkuar më 13 shkurt. “Në Mesdhe, anijet e NATO-s vazhdojnë të patrullojnë e monitorojnë anijet në lidhje me veprimtarinë terroriste. Gjithashtu, ne kryejmë operacione kundër piraterisë në Bririn e Afrikës në bashkëpunim me Bashkimin Europian dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Në të dy teatrot, ne vazhdojmë të mbrojmë

popullin tonë e interesat tanë të përbashkët, duke kapërcyer kërcënimet dhe duke mbajtur të sigurt kordinë e anijeve”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Rasmussen dhe ambasadorët morën informime operacionale nga zëvendësadmirali Peter Hudson, komandant i Komandës Detare së Aleatëve të NATO-s. Gjithashtu, ata u informuan dhe për punën e Shtabit së Forcave Detare të Bashkimit Europian dhe Komandës së Forcave të Bashkuara të Mbretërisë së Bashkuar, të cilat gjithashtu janë të vendosura në bazën Northwood. Kjo vizitë pune theksoi rëndësinë e sigurisë detare të Aleancës.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi

se forcat detare kanë një rol kyç në ruajtjen e gatishmërisë së NATO-s për t’u marrë me sfidat e ardhshme të sigurisë, duke përfshirë kërcënimin që vjen nga raketat balistike. “Në të ardhmen, forcat detare do të bëhen vetëm më të rëndësishme. Vetëm pak ditë më parë, e para nga katër anijet amerikane Aegis mbërriti në Spanjë, si pjesë e kontributit amerikan në zhvillimin e sistemit tonë të mbrojtjes raketore të NATO-s. Do të dëshiroja të shihja më shumë aleatë nga kjo anë e Atlantikut që përmirësojnë radarët e anijeve të tyre si dhe japin kontribute të tjera”, tha ai. Aktualisht, NATO ka dy operacione të mëdha detare, misionin e saj kundër-



piraterisë “Ocean Shield” (Mburoja Oqeanike) në Bririn e Afrikës dhe misionin kundër-terrorizmit “Active Endeavour” (Përpjekja Aktive) në Detin Mesdhe. Këto operacione, të cilat komandohen nga Komanda De-

tare e NATO-s në Northwood, do të rishikohen gjatë muajve të ardhshëm ndërkohë që Këshilli i Atlantikut të Veriut përgatit axhendën për samitin e Uellsit, i cili do të zhvillohet në muajin shtator.

Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe Asambleja Parlamentare e NATO-s diskutojnë përparësitë e Samitit të Uellsit

Rasmussen: Samiti do të formësojë “NATO-n e së ardhmes”, duke marrë vendime të qarta në përmirësimin e aftësive ushtarake, duke ruajtur ndërveprimin dhe thellimin e bashkëpunimit me partnerët e NATO-s rreth globit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, së bashku me ambasadorë nga Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe komandantit suprem të Forcave Aleate në Europë, gjeneralit Breedlove, diskutuan prioritetet për samitin e NATO-s të këtij viti, i cili do të zhvillohet në Uells si dhe çështjet ndërkombëtare me interes të përbashkët me anëtarë të Asamblesë Parlamentare të NATO-s më 17 shkurt. Bisedimet ishin pjesë e bisedimeve të rregullta midis dy organizatave. Sekretari i Përgjithshëm tha se samiti do të formësojë “NATO-n e së ardhmes”, duke marrë vendime të qarta në përmirësimin e aftësive ushtarake, duke ruajtur ndërveprimin dhe thellimin e bashkëpunimit me partnerët e NATO-s rreth globit. Gjithashtu, u diskutua edhe progresi i përfundimit të misionit së udhëhequr nga NATO në Afganistan, duke përfshirë planifikimin për një mision të ri trajnimit, këshillimi dhe ndihme ndaj forcave të sigurisë afgane nga viti 2015 e tutje. Rasmussen theksoi se ai ka



besim tek idetë, kontributet dhe mbështetjen e anëtarëve së Asamblesë Parlamentare të NATO-s në prag të samitit. Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe Asambleja Parlamentare e NATO-s zhvilluan gjithashtu një debat të gjerë mbi çështjet e ndryshme ndërkombëtare të sig-

urisë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s zhvilloi dhe një takim të veçantë me presidentin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, z. Hugh Bayley. Asambleja Parlamentare e NATO-s është një organizatë ndër-parlamentare nga vendet anëtare të NATO-s dhe 14

anëtarë të asociuar. Asambleja është e pavarur nga NATO, por siguron një lidhje midis NATO-s dhe parlamenteve të vendeve të saj anëtare për të ndihmuar ndërtimin e vetëdijes parlamentare dhe publike si dhe mirëkuptimin për politikë të Aleancës.

Rasmussen zhvillon bisedime me ministrin e Jashtëm hungarez

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, prioritetet për samitin e Aleancës së këtij viti, duke përfshirë dhe mënyrat për të rritur bashkëpunimin shumëkombësh të mbrojtjes, me ministrin e Jashtëm hungarez, János Martonyi më 18 shkurt. “Në samitin tonë të Uellsit shtatorin e ardhshëm ne do të sigurohemi që Aleanca jonë unike transatlantike të mbetet efektive në një botë që po ndryshon, kundër kërcënimeve të reja me aftësi e partneritete të forta”, tha

Sekretari i Përgjithshëm. Në fund të bisedimeve të tyre, Rasmussen dhe ministri Martonyi përkujtuan së bashku 15-vjetorin e hyrjes së Hungarisë në NATO, duke hapur një ekspozitë të veçantë për profilizimin e punës së gazetarit fotograf të famshëm hungarez, Robert Capa. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Hungarinë për kontributet e saj në misionet e NATO-s, operacionet në Afganistan dhe Kosovë si dhe angazhimin e saj të fortë ndaj vlerave themelore të Aleancës. Gjithashtu, ai vuri në dukje rëndësinë

që i jep Hungaria dyerve të hapura të NATO-s për të çuar përpara integrimin e Ballkanit Perëndimor. Në ekspozitë, Rasmussen tha se qëllimi i NATO-s ishte të siguronte “ne kurrë nuk përballemi me dëshpërimin, shkatërrimin dhe ndarjen që duruan brezat e mëparshëm në shekullin XX dhe që mund ta shohim këtë kaq gjallërisht në fotot mjeshtrorë të Robert Capas”.

Alba Musaraj
Burimi: nato.int

TAKIMI

Rasmussen takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit Europian

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, diskutoi çështjet ndërkombëtare me interes të përbashkët dhe perspektivat për të çuar më tej ndërveprimin institucional me Thorbjørn Jagland, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit Europian më 14 shkurt. Takimi ishte pjesë e konsultimeve periodike së nivelit të lartë midis dy organizatave dhe të ndërveprimit të NATO-s me organizatat ndërkombëtare në përgjithësi, në frymën e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s përshëndeti rolin aktiv e të rëndësishëm që luan Këshilli i Europës në promovimin e së drejtave të njeriut, demokracisë dhe lirisë së të shprehurit. Gjithashtu, ai përgëzoi angazhimin intensiv të kryer nga Këshilli i Europës për të promovuar një zgjidhje politike për krizën e tanishme në Ukrainë. Rasmussen theksoi të drejtën e njerëzve për t’u angazhuar në tubime paqësore dhe bëri thirrje se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të arritur një marrëveshje politike në Ukrainë. NATO dhe Këshilli i Europës bazohen në të njëjtat vlera themelore. Të gjithë aleatët europianë të NATO-s janë shtete anëtare të Këshillit të Europës. Kanada dhe Shtetet e Bashkuara kanë statusin e vëzhguesit. Konsultimet aktuale në nivel stafi ndërmjet NATO-s dhe Këshillit të Europës janë fokusuar kryesisht në çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen kibernetike dhe anti-terrorizmin.

Për kë mund të shkruaje tani, o Gjokë?

Amaneti i Gjokës për Ilir Shaqirin: “Poezia ime për dëshmorin Feti Vogli të bëhet këngë”

PANO HALLKO

Ditën që u njoftua vdekja e Vaçe Zelës, ti o Gjokë Beci u shtrove në spital. Prej 17 vitesh, follenë tënde për rrezik sëmundjeje, e kishe ngritur në Spitalin Ushtarak që patëm. Atje kanë mbetur shumë pak mjekë me uniformë, të cilët t'i njihnin tik-taket e zemrës tënde të sëmurë, t'i njihnin frymëmarrjet e frymënxjerrjet e mushkërive të tua të lodhura nga kushtet e jetës së vështirë, por edhe nga kuinalët cigare që pate përpirë një jetë të tërë. Kolonel(r) doktor Hajri Gërbi, kolonel doktor Rushan Muhameti, nënkolonel doktor Matjan Kapaj, të shoqëruan me shpirt, deri në frymën e fundit... Njerëzit-doktorë me uniformë, të deshën e të çmuan gjithë kohës. Ata ishin i vetmi “oaz” i mjekësisë sonë - që po thahet-falë “kujdesit” të pushteteve (të paktën të deri djeshëm), - të cilët shërbejnë falas, siç kanë bërë betimin e Hipokratit, por edhe Betimin e Ushtarakut. Ti e kishe kuptuar para shumë vitesh këtë, prandaj edhe këtë herë të fundit, ti shkove e “bëre konak” atje. Ata i rrudhën vetullat më shumë se herët e tjera teksa panë grafitë dhe skanerin e gjoksit tënd, teksa panë se truri yt nuk po furnizohej mirë me gjak. Prandaj, ata që ti i doje aq shumë, bënë të pamundurën, kësaj here për të kryer detyrimin e fundmë karshi teje. Deri sa Ti, u dorëzove në gjumin e pa cak!

Për këtë arsye ndoshta, por edhe për njëmijë të tjera që i dije ti dhe shpirti yt, që i trashëgoje nga geni yt, ti Gjokë pate ndjeshmërinë, ndër të paktët-në mos i vetmi, të shkruaje tekst kënge për kapiten Feti Voglin, i cili ra në krye të detyrës, larg Atdheut, por për interesat e Atdheut. E jo vetëm e bëre poezinë, por edhe ia le amanet Ilir Shaqirit për ta interpretuar.

Të shtunën, kur shpatullat e Vaçes u prehën në dheun shqiptar, ti e ndërpreve komunikimin. E ç'mund të thoshe më tepër? Sa vite që Vaçja ishte larg, edhe pse e dije se ajo ishte e sëmurë e s'mund të këndonte, ti prapë shkruaje tekste. “Ani, ku i dihet ndonjë ditë mund të kthehet ajo, ose...mund t'ia çojnë atje, në Zvicër, rëndësi ka të jenë në dorën e saj”... Tani, përse duhej të flisje, e për kë duhet të shkruaje? Feim Ibrahimit të kishte ikur më herët. Iku edhe Vaçja! Epo ty s'të mbetën dhe shumë gjëra për të bërë. Sepse, “ustai kërkon ustain”, apo jo?!

Kombi shqiptar e ka në magmën e tij sekretin, që e di vetëm ai, se kur duhet të nxjerrë nga gjiri talentet e mëdha dhe ato të zakonshmet. Në bazë të atij sekretit, të asaj magme, ky komb, katër vite më parë se të lindte ty dhe Vaçen, në vitin 1935 kishte lindur Feim Ibra-

Në fjalën e tij gjatë kryerjes së homazheve për poetin, këngëtarin kosovar, Ilir Shaqirin, i cili i ka kënduar tekstet brilante të poetit Gjok Beci, tha për mediet se ai do të përmbushte edhe një amanet të fundit që poeti i kishte kërkuar: “Unë me vete kam poezinë e fundit të tij “Kapiten Feti Vogli”, të cilën do ta realizoj shumë shpejt sepse ishte dhe amaneti i tij”.

himin, diku në Jug të Shqipërisë, pastaj në të njëjtin vit, pra në vitin 1939, lindi ty në fshatin e humbur asokohe - Zajs, buzë Valmorit në Mirditë, e Vaçen, diku në një lagje (po aq të humbur) të Lushnjës së kohës. Ti o Gjokë, ishe i madh, si gjithë të mëdhenjtë (që s'janë dhe aq të shumtë tek ne), ti ishe i thjeshtë si të gjithë ata (që janë të paktë). E veçanta që pate ti ndër të mëdhenjtë e ngjashëm me ty, ishte se ti Gjokë e përzgjidhje fjalën, edhe kur bisedoje me njerëz të thjeshtë në kafën e lagjes, aty pranë shkollës me emrin aq kuptimplotë për ty, “Gjon Buzuku”. Të tjerët, të ngjashmit e tu, e ledhatonin fjalën dhe e skalitnin atë, vetëm kur e shkruanin, por jo kur e flisnin. Ndoshta sepse ty qysh herët në vegjëli, të mundonin e të torturonin pyetjet: “Kush jam? Pse jam? Si nuk duhet të jem?” Prindërit e tu, siç thoshe ti: “Ishin të pa shkollë, por jo të paditur”. Shkëndijën dhe dëshirën e parë për të lexuar, recituar e mësuar përmendësh poezi, ta dha vëllai yt i madh, Pjetri. “Lahutën e Malcisë” edhe pse vonë e preke me dorë, ti e mësoje pranë zjarrit, mbrëmjeve dimërore nga recitimi i Pjetrit, varg pas vargu e pjesë pas pjesë. Pastaj, me kalimin e kohës, si nëpër gurët kilometrikë, kalove nga Fishta tek Dante, nga Naimi tek Pushkini, nga Lasgushi te Bërnsi e Esenini, nga Omar Kajami, tek... gjithkush që të mësonte të merreshe me veten. Sepse njeriu duhet të merret me veten, të pyesë veten, domethënë të jetë i preokupuar për atë ç'ka është, e doemos zgjidhjen ta gjejë në shkollim e arsim, kryesisht në lexim. Pastaj lëndën ty ta dha vetë jeta, vetë njerëzit. 20 vite më parë, kur gjendja jote shëndetësore, filloi me problemet e saj të moshës dhe jo vetëm, ty të sillej ndërmend ngultas Xhordano Brunoja. Ai nuk të fliste, e ti nuk i flisje. Ai pat folur, pat



thënë: Toka! Por edhe ti pate folur, e pate thënë: Kënga! Fakti është që kënga ashtu si Toka rrotullohet, por ndërsa Tokën ne njerëzit nuk mundemi ta rrotullojmë, këngën mundemi. Pra, ashtu sikundër askush nuk mund të thotë: E rrotullova unë tokën!, asnjëri prej jush të këngës nuk ka të drejtë të thotë: Deri tek unë, dhe ndaluni! Gjithë shqiptarët janë mrekulluar nga vargjet e tua, të gjithë mbamendësit në këtë vend, ende mërmërisin në buzë vargjet e tua: “Një zambak i bardhë në gur”... “Po ku ka si Ty, o Shqipëria ime”... Por, sa pak njerëz e dinë se ti ato vargje i shkrove për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve, në Koncertet e Majit. Sa pak njerëz mund ta dinë se ty atje në Mirditën tënde të erdhën e të gjetën dy miq që meritonin shumë respekt dhe përkushtim: Artisti i madh Besim Zekthi dhe kolegu i tij, piktori Ksenofon Dilo? E ti u mbylle në zyrën tënde në pallatin e kulturës në Mirditë. Përballë dritares kishe bjeshkën. Të kaloi si në film të

shkurtër fëmijëria. Fëmijëria të erdhi në ndihmë. Atje lart në kreshtë, i vogël, dikur të kishte shtangur një masiv shkëmbor, krejt i kuq, si një gjurmë e stërmadhe, së cilës me një adhurim konfuz, vetëdija jote i mbeti skllave për krejt kohën. Ike atë ditë dhe shkove në fshatin tënd, në Zajs. E gdhive natën, e në mëngjes herët dole atje ku dilje i vogël, përballë shkëmbit të stërmadh... “Mekanizmat” krijuese u vunë në lëvizje dhe u krijua ajo që i ra në dorë Feim Ibrahimit dhe i shkoi për zemër emblematikes sonë Vaçe. Veç edhe pak për të kujtuar takimin tënd të parë me këngën e plotë. Të kishin ftuar për vallen e kënduar, kur në korridorin e gjatë të katit të tretë të Teatrit të Operës, dëgjoje një zë si gurgullimë bjeshke: Ju jeni Gjoka? -Gjokë më thonë. -Gjoka i Mirditës? -Nga Mirdita jam. - Që keni shkruar “Zambakun”?... -Ishte diçka e tillë në Festivalin folklorik, i the ti i përhumur. Zëri përballë ngulmoi: -Zambakun e bardhë e ka kompozuar Ibrahimit - dhe të tërhoji

fort për krahu:- Eja, se kjo është pianistja, eja ta dëgjosh. Ishte Vaçja vetë, dhe ishte mrekullia vetë...

Fole përmes penës tënde të rrallë e sqimatore, por kush të dëgjoji?

Ti diku, thua: “Kanë ra n'gjak e janë ngujue / Janë lodhë qyqet me i pajtue” N'ara të bukës ka mbi ferra / Ka mbet lumi me një valë / Ka mbet votra me një djalë.” Me një fjalë, përshkruan atë se çfarë ndodh në një “rënie në gjak”. E gjithë jeta paralizohet, asnjë fëmijë nuk shkollohet, vdekja vjen rrotull kullave si një korb i zi me draprin e tmerrshëm të kositjes së jetëve. Prandaj edhe thua e bën apel: “Kush asht burrë e në Zot beson/ Gjakun fal e gjak s'kërkon/ Koha sot s'asht me derdhë gjak/ Ndihmo Zot të bajmë konak”. Dhe Ti, përfundon duke vikatur: “Në u vrafshim për çdo fjalë / Vetëm vdekja mbetet gjallë!”... Ti pate dy lloj prindërisht: realë e virtualë. Prindërit e tu virtualë janë Skënderbeu dhe Nënë Tereza. Pra shembujt s'na mungojnë, se ata ishin shembull edhe për Europën në të cilën ne përpigemi të hyjmë shtetërisht. Ndërkohë të gjithë e dimë dhe e pranojmë se jemi nga katundi i Nënë Terezës që lutet pa pra : “Në këtë tokë me diell mbi krye / Vijmë me u dashtë e jo me u urrye”... Feimi i madh, vdiq në Torino. Vaçja e madhe, vdiq në Zvicër. Po ti o Gjokë, ku vdiqe? A ka ndonjë derë hyrjeje pallati në Tiranë, që mban emrin Gjokë Beci? Ti vdiqe në hyrjen (e radhës si qiraxhi), më saktë, vdiqe (dhe mbete i pavdekshëm, në... “Këngë e Ligjërime”) në vargjet e spikatura të poezisë sonë. Ti na bëje thirrje që... “Gjersa dielli s'na ka braktisur, le të nxitojmë të kryejmë Aktin më të madh, më qytetar e më të domosdoshëm: Ç'kurorëzimin me Urrejtjen!... Ndoshta për të materializuar këtë, ti zgjodhe të ikësh nga jeta, pikërisht Ditën e Dashurisë...



17 Pavarësi

Kosova, 6 vjet

UÇK, pjesë e thesarit të vlerave kombëtare

QLMI organizon veprimtarinë “17 Shkurti - Përkujtimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës”

Në kuadër të 6-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, QLMI organizoi veprimtarinë “17 Shkurti - Përkujtimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës”. Në këtë veprimtari morën pjesë drejtues të institucioneve, pedagogë të AFA-së, punonjës të bibliotekave në KDS-së, kursantë etj. Në fjalën e hapjes mbajtur nga drejtori i QLMI, z. Bernard Zotaj, ndër të tjerash u theksua se: “Tashmë lufta ka përfunduar e Kosova ka 6 vjet që është shtet dhe jeton e lirë. Ajo në përvjetorin e gjashtë është njohur nga 106 shtete të botës. Këtë luftë e bëri palca e patriotizmit shqiptar. Luftën e bënë ata që financuan, ata që siguruan armë, që i transportuan... të gjithëve u duhet njohur merita. Por mbi të gjitha shqiptarët sot dhe nesër u drejtohen atyre që ideuan, organizuan dhe drejtuan luftën, ata që dolën në fushëbetejë me betimin “Ja liri, ja vdekje! Ata që bënë luftën e fundit të lavdishme të kombit shqiptar dhe lufta e tyre, lufta e UÇK-së, tanimë pjesë e thesarit të vlerave kombëtare, ju përket të gjithë shqiptarëve dhe historisë sonë”.

Aktiviteti vijoi me prezantime të materialeve të ndryshme, botime të autorëve shqiptarë dhe të huaj dhe shkrime, mbi përpjekjet dhe rrugëtimin drejt Bashkimit Kombëtar të popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi, të tilla si: “Rrugëtimi dhe mbijetesa drejt Bashkimit Kombëtar - Pavarësia e Kosovës; “Kosova, një realitet evropian”; “Libra të botuar nga autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj për Kosovën”.



Himni i Kosovës

*O mëmëdhe i dashur, vend i trimnisë
Çerdhe e dashurisë
N'ty shqiptet fluturojnë dhe yjet ndriçojnë
Vend i të parëve tonë*

*Ti qofsh bekue për jetë e mot
O nënë e jonë
Ne të dalim zot*

*O mëmëdhe i dashur, vend i trimnisë
Çerdhe e dashurisë*

